




REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës - Председник Општине
Belediye Başkanı

01 Nr. 652/25 Dt. 30.12.2025



RAPORTI VJETOR I KRYETARIT SHAQIR TOTAJ

(Janar-Dhjetor 2025)



Prizren, 2025

Përmbajtja:

Koordinimi me ekzekutivin dhe drejtoritë komunale	8
Takime me ambasadorë dhe përfaqësues diplomatikë	8
Bashkëpunimi me institucione vendore, qendrore dhe ndërkombëtare	9
Takimet me organizatat e shoqërisë civile	9
Marrëveshjet e bashkëpunimit (MoU)	9
ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN	11
ZYRA E PROKURIMIT	12
Kapacitetet dhe Organizimi	12
Procedurat dhe Kontratat	13
Vlera Financiare	13
Ankesa dhe Kërkesa për Rishqyrtim	13
NJËSIA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE	13
Lëndët e pranuar dhe komunikimi zyrtar	14
Konkurset për Nëpunës të Shërbimit Civil	14
Konkurset për Nëpunës të Shërbimit Publik	14
Konkurset për Nëpunës Teknik dhe Mbështetës	15
Vlerësim i përgjithshëm	15
Përfundim	15
ZYRA LIGJORE	15
ZYRA E PËRFAQËSUESIT LIGJOR	16
Të dhëna të përgjithshme dhe volumi i punës	16
Lëndët më të shpeshta dhe natyra e kontesteve	16
Rezultatet e proceseve gjyqësore	17
Bashkëpunimi ndërinstitucional	17
Vlerësim i përgjithshëm	18
Përfundim	18
ZYRA PËR ÇËSHTJE PRONËSORO-JURIDIKE	18
ZYRA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	19
Objektiva e Auditimit të Brendshëm për vitin 2025:	19
1. Rishikimi periodik dhe vjetor i zbatimit të rekomandimeve	19
2. Realizimi i detyrave audituese sipas Planit të Punës 2025	19
3. Raportimi periodik	19

4. Bashkërendimi institucional dhe detyrat këshilluese.....	20
Rezultatet kryesore/të arritura gjatë periudhës janar – 30 nëntor 2025	20
Auditimet e realizuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2025:	20
Aktivitetet e tjera të realizuara nga NjAB gjatë periudhës janar - 30 nëntor 2025.....	21
Bashkërendimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA).....	21
Raportet periodike për rishikimin e rekomandimeve.....	21
Raportet periodike dhe vjetore për organet përgjegjëse	21
Takimet e Komitetit të Auditimit	21
Pjesëmarrja në projekte dhe aktivitete profesionale	21
ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE	22
ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	23
Ngritja e mirëqenies sociale	23
Kthimi dhe riintegrimi	24
Qëndrueshmëria, siguria dhe shërbimet.....	24
Bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar	24
Përfundim.....	24
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE	25
Kontrata për shërbime të rregullta	27
Kontrata për projekte të veçanta.....	27
Aktivitete dhe fushata mjedisore	28
DREJTORIA E ADMINISTRATËS	33
Administrata e përgjithshme dhe menaxhimi financiar	33
Shërbimet administrative dhe ekspedita	33
Spektori i Gjendjes Civile	34
Teknologjia Informative (IT)	34
Mbështetja logjistike dhe infrastruktura	35
Barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut.....	35
Përfundim.....	35
DREJTORIA PËR EMERGJENCË DHE SIGURI	35
Projektet dhe investimet.....	36
Intervenimet nga Brigada e Zjarrfikësve.....	36
Aktivitetet e Inspektorëve të Preventivës.....	36
Përfundim.....	37

DREJTORIA PËR EKONOMI DHE FINANCA	37
Buxheti dhe Thesari	38
Të hyrat vetanake komunale	38
Shpenzimet buxhetore.....	38
Tatimi në Pronë	39
Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve.....	39
Përfundim.....	40
DREJTORIA E INSPEKTORATEVE	40
Sektori i Tregut – Mbrojtja e konsumatorit dhe siguria e produkteve	40
Sektori Komunal dhe Inspektorati i Mjedisit	41
Inspektori i Komunikacionit.....	42
Sektori i Ndërtimit – Mbikëqyrja e rendit ndërtimor.....	42
Përfundim.....	42
DREJTORIA KOMUNALE E SHËNDETËSISË	43
Investimet kapitale dhe infrastruktura shëndetësore	43
Mallrat dhe shërbimet shëndetësore	44
Shërbimet shëndetësore të ofruara.....	44
Promovimi i shëndetit dhe aktivitetet vetëdijësuese	45
Mbështetja financiare për qytetarët.....	45
Monitorimi, bashkëpunimi dhe donacionet.....	46
Përfundim.....	46
DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	48
Projektet kapitale dhe dokumentet strategjike të planifikimit.....	48
Rehabilitimi i kulmeve dhe korridoreve në objektet e banimit kolektiv	48
Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK)	49
Plani Rregullues Urban për Zonën e Veçantë – Parku i Biznesit.....	49
Shërbimet administrative dhe statistikat e punës (Urbanizmi)	50
Statistikat: Janar–Qershor 2025	50
Statistikat: Korrik–Nëntor 2025.....	50
Legalizimet dhe Task Forca	51
Vlerësim i përgjithshëm dhe sfidat	51
Përfundim.....	52
DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT	52

Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave	52
Raporti mbi të arriturat	52
Kultura dhe Mjedisi	53
Raporti mbi të arriturat	53
Mësimdhënia dhe nxënia	54
Raporti mbi të arriturat	54
Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	54
Raporti mbi të arriturat	54
Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve	55
Raporti mbi të arriturat	55
Të dhënat statistikore	56
Arsimi i komuniteteve	56
AKTIVITETET:	56
Trajnime, punëtori dhe punë në ekip	57
Infrastruktura në shkollat e Komunës së Prizrenit.....	57
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	61
Projektet kapitale dhe infrastruktura kulturore, rinore dhe sportive	61
Mbështetja financiare dhe bashkëpunimi me OJQ-të	62
Organizimi i aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive.....	63
Vlerësim i përgjithshëm	63
DREJTORIA E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK	66
Projektet e përfunduara dhe investimet kryesore:	66
Aktivitetet kryesore:	67
Panairët:	68
DREJTORIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE	75
Projektet:	75
Subvencionet:	76
Memorandume bashkëpunimi:	77
Qendra për Punë Sociale	78
DREJTORIA E GJEODEZIZË DHE KADASTRIT	82
DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	84
Projektet në realizim	85
Kapitale:	85

Subvencione me bashkëfinancim:	85
Shërbime:	86
PËRMBLEDHJE PËRFUNDIMTARE	88
Qeverisje funksionale dhe administratë në shërbim të qytetarëve.....	88
Stabilitet financiar dhe menaxhim i përgjegjshëm i buxhetit	89
Investime publike dhe zhvillim urban i planifikuar	89
Shëndetësia, siguria dhe shërbimet sociale	89
Kulturë, rini dhe sport – identitet dhe gjallëri qytetare	90
Partneritet, transparencë dhe besim qytetar.....	90
Shikimi përpara – përgjegjësi dhe vision	90
Falënderim	91

Të dashur qytetarë,

Në prag të mbylljes së vitit 2025, dëshiroj t'ju shpreh falënderimin tim të sinqertë për mbështetjen dhe besimin që vazhdimisht i keni dhënë punës sonë të përbashkët për zhvillimin e Komunës së Prizrenit. Rrugëtimi i nisur katër vite më parë ka pasur sfidat e veta, por mbi të gjitha është shënuar me rezultate konkrete që sot ndihen drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve.

Gjatë kësaj kohe, kemi realizuar projekte të rëndësishme infrastrukturore në të gjitha zonat e komunës, me fokus të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës në lagjen Bazhdarhane, krijimin dhe rregullimin e hapësirave publike cilësore, përfshirë rehabilitimin e Shadërvanit, si dhe çlirimin e shumë hapësirave që më herët kanë qenë të bllokuara. Këto ndërhyrje i kanë dhënë qytetit më shumë hapësirë, qasje më të lehtë dhe barazi për të gjithë.

Kultura dhe sporti janë shndërruar në shtylla të rëndësishme të jetës qytetare. Festivalet, aktivitetet për të rinjtë dhe mbështetja e vazhdueshme për klubet sportive e kanë bërë Prizrenin qytet të gjallë, aktiv dhe të njohur jo vetëm në Kosovë, por edhe përtej saj.

Njëkohësisht, kemi avancuar ndjeshëm në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale. Komuna e Prizrenit ka shënuar progres të vazhdueshëm në vlerësimet e organizatave që masin transparencën komunale, duke dëshmuar përkushtimin tonë për qeverisje të përgjegjshme dhe të nderhme.

Këto rezultate janë fryt i bashkëpunimit të ngushtë dhe punës së përkushtuar për ta bërë Prizrenin vend më të mirë për të jetuar. Kemi vendosur themele të forta dhe standarde të reja për zhvillimin lokal, mbi të cilat do të ndërtojmë projekte të reja edhe në vite që vijnë.

Faleminderit për besimin dhe partneritetin tuaj. Së bashku do të vazhdojmë ta ndërtojmë të ardhmen e Prizrenit.

Prizreni në punë!

Shaqir Totaj

Në vijim ju paraqesim një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Prizrenit gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025, duke reflektuar angazhimin institucional në koordinimin e qeverisjes lokale, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, adresimin e kërkesave qytetare dhe avancimin e marrëdhënieve me partnerë vendorë e ndërkombëtarë.

Koordinimi me ekzekutivin dhe drejtoritë komunale

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar takime të rregullta pune me drejtorët e komunës, me qëllim monitorimin e zbatimit të planeve vjetore, shqyrtimin e sfidave dhe marrjen e vendimeve të përbashkëta në proceset qeverisëse. Krahas tyre, janë mbajtur edhe takime të veçanta me drejtori dhe zyrtarë komunalë për trajtimin e çështjeve specifike dhe projekteve prioritare sipas sektorëve përkatës.

Takime me ambasadorë dhe përfaqësues diplomatikë

Zyra e Kryetarit ka mirëpritur përfaqësues diplomatikë të vendeve mike, me synim thellimin e bashkëpunimit bilateral dhe promovimin e mundësive të reja për zhvillim lokal. Në këtë kuadër, janë zhvilluar takime me ambasadorët e Turqisë, Bashkimit Evropian, Finlandës, Australisë (me seli në Kroaci dhe Kosovë), Gjermanisë, Francës, etj.





Bashkëpunimi me institucione vendore, qendrore dhe ndërkombëtare

Kryetari i Komunës ka zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve të sigurisë, organizatave zhvillimore dhe shoqatave të ndryshme kombëtare, me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe identifikimin e fushave të përbashkëta për mbështetje dhe ndërhyrje. Ndër partnerët me të cilët është bashkëpunuar përfshihen: KFOR, GIZ, UNDP, Peace Corps, Hidroregjioni Jugor, organizata të komuniteteve etnike si dhe institucione arsimore dhe kulturore.

Takimet me organizatat e shoqërisë civile

Zyra e Kryetarit ka vazhduar të jetë e hapur për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar takime të shumta me OJQ që veprojnë në fusha si: të drejtat e njeriut, rinia, arsimi dhe mbrojtja sociale. Ky bashkëpunim ka kontribuar në hartimin dhe zbatimin e iniciativave dhe projekteve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së komunitetit.

Marrëveshjet e bashkëpunimit (MoU)

Në kuadër të forcimit të partneriteteve dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar këto marrëveshje bashkëpunimi:

- MoU me Agjencinë për Zhvillim Rajonal (AZHR)
- Marrëveshje me ekipin për prezantimin e Skemës së Granteve të WBF në partneritet me BE-në
- Nënshkrimi i kontratës me kompaninë “Ekoregjioni”
- MoU me GIZ dhe Makerspace
- Nënshkrimi i kontratës me “Ekoregjioni” për shërbimet e varrimit (në prani të KBI-së)

- MoU ndërmjet Projektit DEMOS të zbatuar nga HELVETAS dhe Komunës së Prizrenit
- MoU mes Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova
- Marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëfinancimin e ndërtimit të objektit administrativ për nevojat e zejtarëve (Komuna e Prizrenit – MZHR)
- MoU me Policinë e Kosovës
- MoU mes Komunës së Prizrenit, DVV International dhe OJQ THY
- MoU me organizatën Concordia
- Marrëveshje trepalëshe mes Komunës, Policisë dhe Postës së Kosovës
- Marrëveshje me fondacionin “Halil Kastrati” për ndërtimin e kuzhinës popullore
- MoU me DEMOS për grantin e Performancës për projektin e Stacionit të Autobusëve
- MoU për Forumet e Komuniteteve për Energjinë e Efikase (FKEE)
- Marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit “Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit”
- Nënshkrimi i kontratës me Ekoregjonin
- Aneks MoU me Komunës së Prizrenit dhe AZHR Jug
- MoU mes Komunës së Prizrenit, MBG Sh.P.K. dhe KEDS
- MoU mes Komunës së Prizrenit dhe Flutura Academy
- MoU me KRU “Hidroregjioni”
- Nënshkrimi i kontratës me Ekoregjonin
- Marrëveshje bashkëfinancimi me shoqatën “Jetimat e Ballkanit”
- MoU me Education Empowerment Initiative
- Aneks MoU me MMPHI për ndërtimin e teleferikut në Kalanë e Prizrenit
- Plotësim-ndryshim i MoU për financim të projekteve infrastrukturore
- MoU me FKEE për objektet në pronësi të Komunës





ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Njësia për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2025 ka ruajtur me kujdes dhe përkushtim, profesionalizmin, etikën dhe integritetin e komunikimit dhe informimit me publikun dhe audiencave tjera me interes, si OJQ-të, mediat, gazetarët dhe grupet tjera shoqërore. Gjatë kësaj kohe janë publikuar të gjitha dokumentet zyrtare të hartuara nga Kryetari i Komunës, Kuvendi dhe njësitë/zyrat tjera administrative. Aktivitetet, projektet dhe e gjithë vendimmarrja komunale është bërë publike për qytetarët dhe të interesuarit tjerë në përputhje të plotë me ligjet: Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Udhëzimet Administrative për komunikim publik dhe aktet e brendshme komunale.

Të gjitha njoftimet, thirrjet publike, vendimet dhe dokumentet e tjera zyrtare janë lekturuar dhe përkthyer në gjuhët zyrtare të komunës (shqip, boshnjakisht, turqisht dhe romisht), po ashtu është bërë edhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të komunës dhe në platformat sociale brenda afateve ligjore dhe procedurave të përcaktuara me udhëzime administrative.

Gjatë vitit 2025 janë organizuar 9 dëgjime buxhetore me qytetarë për hartimin e buxhetit të vitit vijues 2026. Po ashtu janë organizuar edhe dëgjime tjera buxhetore për KAB-in (2026–2028).

Njësia për Komunikim me Publikun ka këshilluar dhe ndihmuar në organizimin profesional dhe ligjor të konsultimeve publike për dokumentet strategjike dhe administrative të hartuara nga Kryetari, kuvendi dhe drejtoritë komunale, duke zbatuar Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike. Po ashtu edhe këtë vit komuna, në kuadër të procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje për vitin 2026, ka organizuar 7 takime publike me qytetarë në lokalitete të ndryshme të Komunës së Prizrenit.

Në Janar 2025, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, Suedinë dhe Zvicrën, ka njoftuar zyrtarisht se Komuna e Prizrenit është përfituese e Grantit të Performancës në vlerë prej 2 milion e 47 mijë eurove, bazuar në vlerësimin e lartë të komunës sonë për përmbushjen e indikatorëve ligjorë, administrativë dhe të qeverisjes së mirë.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), përmes: Transparometrit 2025, e ka renditur Komunën e Prizrenit të parën në mesin e komunave të mëdha të vendit, duke e vlerësuar për përmbushjen e indikatorëve të transparencës dhe llogaridhënies në nivelin 98.96%.

Instituti GAP, në raportin Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave, e ka vlerësuar komunën tonë me 100 pikë nga 100 të mundshme, duke e renditur si komunën me transparencën më të lartë buxhetore në nivel vendi.

Gjatë periudhës raportuese, Njësia për Komunikim me Publikun ka pranuar 122 kërkesa për qasje në dokumente publike. Të gjitha kërkesat janë trajtuar brenda afateve ligjore, në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe procedurat e brendshme komunale. Dokumentet e kërkuara nga qytetarët, OJQ-të, gazetarët dhe palët tjera janë ofruar brenda afateve ligjore. Në disa raste dokumentet e kërkuara nga komuna jonë janë ofruar edhe me këshillimet ligjore të AIP-së.

Raporti më i zgjeruar dhe detaje tjera të punës dhe aktiviteteve të Njesisë për Komunikim me Publikun, do të publikohet në faqen zyrtare të komunës.

ZYRA E PROKURIMIT

Gjatë vitit fiskal 2025, Zyra e Prokurimit e Komunës së Prizrenit ka zhvilluar dhe menaxhuar me përgjegjësi proceset e prokurimit publik, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, duke synuar transparencë, efikasitet dhe menaxhim racional të fondeve publike.

Kapacitetet dhe Organizimi

Zyra e Prokurimit gjatë vitit 2025 ka funksionuar me një përbërje prej katër zyrtarësh të certifikuar për prokurim publik, të cilët kanë qenë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi ligjore.

Procedurat dhe Kontratat

Gjatë vitit 2025 janë iniciuar gjithsej 146 procedura të prokurimit, që përfshijnë: punë, shërbime, furnizime të vlerave minimale, të vogla, të mesme dhe të mëdha. Po ashtu, janë zhvilluar 26 procedura të vlerave minimale, prej të cilave 8 për furnizime dhe 18 për shërbime. Si rezultat i këtyre procedurave, gjatë vitit janë nënshkruar gjithsej 157 kontrata, përfshirë edhe kontrata të bartura nga vitet paraprake (21 kontrata nga viti fiskal 2024 dhe 1 kontratë nga viti fiskal 2022); janë nënshkruar 10 aneks-kontrata, në përputhje me nevojat dhe zhvillimet e projekteve përkatëse. Kontratat e nënshkruara përfshijnë procedura të vlerave minimale, të vogla, të mesme dhe të mëdha si dhe konkurse projektimi e procedura njëburimore pa publikim të njoftimit për kontratë.

Vlera Financiare

Vlera totale e kontratave të nënshkruara gjatë vitit fiskal 2025 deri më 02.12.2025 arrin në 41,642,150.46 euro.

Ankesa dhe Kërkesa për Rishqyrtim

Gjatë vitit 2025 janë paraqitur 138 kërkesa për rishqyrtim, për të cilat janë nxjerrë vendime përkatëse nga Autoriteti Kontraktues; janë parashtruar gjithsej 80 ankesa, prej të cilave 77 janë trajtuar dhe zgjidhur, 3 ankesa mbeten në proces të pritjes së vendimeve nga OSHP për procedim të mëtejshëm.

Përfundim: Zyra e Prokurimit gjatë vitit 2025 ka dëshmuar angazhim të vazhdueshëm në zbatimin korrekt të procedurave të prokurimit publik, duke ofruar mbështetje profesionale për të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative të Komunës së Prizrenit si dhe ka kontribuar në rritjen e transparencës, ligjshmërisë dhe efikasitetit në menaxhimin e fondeve publike.

NJËSIA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2025 ka ushtruar funksionet e saj në administrimin e personelit komunal, zbatimin e procedurave të rekrutimit, trajtimin e kërkesave administrative dhe garantimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, shërbimin publik dhe stafin teknik-mbështetës. Veprimtaria e Njesisë është zhvilluar në përputhje me parimet e transparencës, barazisë dhe efikasitetit administrativ.

Lëndët e pranuara dhe komunikimi zyrtar

Gjatë periudhës 01.01.2025 – 03.06.2025, Njësia ka pranuar gjithsej 902 kërkesa, ndërsa gjatë periudhës 03.06.2025 – 01.12.2025 janë pranuar 1,887 kërkesa.

Në total për vitin 2025:

- 2,789 kërkesa të pranuara, të cilat janë shqyrtuar sipas procedurave ligjore, me një pjesë ende në proces.

Sa i përket komunikimit zyrtar:

- 1,131 shkresa dhe komunikime elektronike në gjashtëmujorin e parë;
- 1,536 shkresa dhe komunikime elektronike në gjashtëmujorin e dytë.

Gjithsej për vitin 2025: **2,667** shkresa dhe komunikime elektronike.

Konkurset për Nëpunës të Shërbimit Civil

Konkurset e proceduara:

Numri i konkurseve të shpallura për nëpunës të shërbimit civil për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025 është 39, prej të cilëve:

- 39 konkurse janë shpallur për pranim në shërbimin civil, ku 19 prej tyre kanë përfunduar me sukses, 5 janë në afat të ankesave dhe 14 të dështuara pa kandidatë fitues dhe 1 është në procedurë.

Konkurset për Nëpunës të Shërbimit Publik

Gjatë vitit 2025 janë shpallur gjithsej 23 konkurse për nëpunës të shërbimit publik, me 204 vende të lira pune, të shpërndara sipas sektorëve:

Në Shëndetësi:

- 14 konkurse me 93 vende të lira;
- 2 vende të plotësuar me sukses;
- 1 vend i dështuar;
- 90 vende në procedurë.

Në Arsim:

- 9 konkurse me 111 vende të lira;
- 54 persona të pranuar;
- pjesa tjetër e vendeve në faza procedurale sipas konkursit përkatës.

Konkurset për Nëpunës Teknik dhe Mbështetës

Gjatë vitit 2025 janë shpallur gjithsej 4 konkurse për staf teknik dhe mbështetës, me 41 vende të lira, me rezultatet si në vijim:

- 17 persona të pranuar;
- 15 vende të lira në procedurë;
- pjesa tjetër e vendeve të mbetura pa kandidat fitues.

Vlerësim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka përballuar një volum të lartë të kërkesave dhe procedurave të rekrutimit, veçanërisht në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit. Pavarësisht ngarkesës administrative, proceset janë zhvilluar në përputhje me standardet ligjore, duke ruajtur transparencën dhe barazinë në trajtimin e kandidatëve dhe nëpunësve.

Përfundim

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore mbetet e përkushtuar në forcimin e administratës komunale, përmirësimin e proceseve të rekrutimit dhe menaxhimin efikas të resurseve njerëzore, me synim rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët e Komunës së Prizrenit.

ZYRA LIGJORE

Zyra Ligjore gjatë vitit 2025, ka ushtruar funksionet e saj në sigurimin e ligjshmërisë institucionale, mbështetjen juridike për Kryetarin, drejtoritë dhe njësitë komunale si dhe në përfaqësimin e interesit të Komunës në procedura administrative dhe gjyqësore. Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë hartuar dhe proceduar për nënshkrim gjithsej 410 vendime dhe 14 autorizime, përfshirë 258 vendime dhe 5 autorizime në periudhën janar–qershor dhe 152 vendime e 9 autorizime në periudhën qershor–dhjetor. Veprimtaria e Zyrës ka përfshirë gjithashtu hartimin e akteve juridike, dhënien e

opinioneve ligjore, kryesimin e komisioneve për shqyrtimin e ankesave administrative dhe përfaqësimin e Komunës pranë organeve kompetente, duke kontribuar në forcimin e sigurisë juridike dhe stabilitetit institucional.

ZYRA E PËRFAQËSUESIT LIGJOR

Zyra e Përfaqësuesit Ligjor, në kuadër të Komunës së Prizrenit, ka për mision përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave ligjore të Komunës dhe institucioneve që financohen nga Komuna, në procedura civile, administrative dhe përmbartimore, në të gjitha nivelet e gjyqësorit të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2025, ka zhvilluar aktivitet intensiv profesional, duke u përballur me një numër të konsiderueshëm lëndësh dhe angazhime të vazhdueshme në seanca gjyqësore, përgatitje aktesh procedurale dhe ushtrim mjetes juridike.

Të dhëna të përgjithshme dhe volumi i punës

Gjatë vitit 2025, Zyra e Përfaqësuesit Ligjor ka trajtuar një volum të lartë lëndësh dhe akte juridike, përkatësisht:

- Lëndë të reja të pranura për procedim: mbi 200 lëndë;
- Akte gjyqësore të shqyrtuara: mbi 120 akte;
- Përgjigje të përgatitura ndaj padive: 182 përgjigje;
- Akte të ndryshme procedurale të përgatitura: 72 akte;
- Seanca gjyqësore të përfaqësuara: 387 seanca.

Lëndët e trajtuara kanë përfshirë çështje me rëndësi të veçantë financiare dhe institucionale për Komunën e Prizrenit.

Lëndët më të shpeshta dhe natyra e kontesteve

Gjatë vitit 2025, Zyra e Përfaqësuesit Ligjor ka përfaqësuar Komunën kryesisht në këto kategori të lëndëve:

- kompensim i paluajtshmërisë;
- vërtetim i pronësisë;
- konteste nga marrëdhënia e punës;
- pengim posedimi;

- kompensim dëmi;
- procedura përmbartimore dhe administrative.

Këto lëndë kanë kërkuar përgatitje të detajuar juridike, koordinim të vazhdueshëm me drejtoritë komunale dhe përfaqësim aktiv në të gjitha instancat gjyqësore.

Rezultatet e proceseve gjyqësore

Gjatë vitit 2025, Zyra e Përfaqësuesit Ligjor ka arritur rezultate të rëndësishme në mbrojtje të interesit publik:

- Një numër i konsiderueshëm vendimesh në favor të Komunës, ku gjykatat e shkallës së parë kanë refuzuar kërkesëpaditë dhe ankesat e palëve paditëse;
- Çështje të kthyer në rigjykim, si rezultat i ankesave të ushtruara nga Zyra, të cilat janë aprovuar nga gjykatat më të larta;
- Ankesa të ushtruara në gjykata kompetente: 22 ankesa;
- Mjete të jashtëzakonshme juridike të ushtruara në Gjykatën Supreme: 3 raste.

Këto rezultate dëshmojnë angazhimin profesional dhe efikas të Zyrës në mbrojtjen e interesave ligjore të Komunës.

Bashkëpunimi ndërinstytucional

Zyra e Përfaqësuesit Ligjor ka bashkëpunuar ngushtë me drejtoritë komunale dhe njësitë përkatëse për sigurimin e dokumentacionit, informatave dhe qëndrimeve institucionale në procedurat gjyqësore.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar:

- rreth 45 kërkesa dhe akte përcjellëse drejtuar drejtorive komunale dhe njësive përgjegjëse;
- komunikime të vazhdueshme zyrtare për harmonizimin e qëndrimeve ligjore dhe mbrojtjen e interesit të Komunës në procedura gjyqësore.

Vlerësim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2025, Zyra e Përfaqësuesit Ligjor ka funksionuar me përkushtim të lartë profesional, duke përballuar një ngarkesë të konsiderueshme pune dhe duke menaxhuar lëndë me kompleksitet të lartë juridik. Volumi i lëndëve dhe natyra e tyre kanë qenë në përputhje me trendet e viteve të mëparshme, ndërsa rezultatet e arritura dëshmojnë efikasitet dhe përfaqësim cilësor.

Përfundim

Zyra e Përfaqësuesit Ligjor mbetet e angazhuar për të siguruar përfaqësim profesional, efikas dhe të përgjegjshëm të Komunës së Prizrenit në të gjitha instancat gjyqësore. Në vitet në vijim, Zyra do të vazhdojë ta forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe do të avancojë në mbrojtjen e interesave ligjore të Komunës së Prizrenit.

ZYRA PËR ÇËSHTJE PRONËSORO-JURIDIKE

Në periudhën Janar-Dhjetor 2025 në Sektorin për Çështje PronëSORO-Juridike janë pranuar gjithsejtë 741 lëndë, prej të cilave në afatin e paraparë ligjor janë shqyrtuar dhe aprovuar 652 lëndë, janë refuzuar 53 lëndë, ndërsa 36 lëndë janë në procedurë e sipër.

Më poshtë japim shënime rreth lëndëve të pranura dhe të kryera sipas detyrave të punës dhe procedurat që kryhen pranë Sektorit për Çështje PronëSORO-Juridike, sipas natyrës dhe sistematizimit të punëve:

- Procedura e shpronësimit të plotë dhe jo të plotë si dhe procedura lidhur me bartjen administrative (kjo procedurë është zhvilluar në emër të Kryetarit të Komunës, në pajtim me Ligjin Nr.03/L-139).
- Lëndë të arritura – 0, të aprovuara – 0, në procedurë e sipër – 0, të refuzuara - 0.
- Procedura lidhur me përpilimin e kontratave mbi qiranë për lokalet pronë e KK Prizrenit dhe kontrolli lidhur me përmbushjen e obligimeve që dalin nga to.
- Lëndë të arritura – 630, Kontrata të lidhura - 0, Vërejtje - 45, Vërejtje para padisë - 13, kërkesa - 533, njoftime dhe vendime – 9, ekzekutime - 0 dhe konkluzion mbi ekzekutim - 3.
- Procedura lidhur me vërtetimin dhe konstatimin e uzurpimit arbitrar të tokës në pronësinë shoqërore - lëndë të arritura dhe të bartura – 8, konkluzione për ndërprerjen e procedurës – 1,

njoftime mbi ndërprerjen e procedurës – 0, aktvendime të aprovuara – 0, lëndët në procedurë e sipër – 7.

- Kërkesa të ndryshme dhe njoftime për Gjykatën Komunale, Asamblenë, Përfaqësuesin e Komunës, konfirmimi dhe qasja në dokumente zyrtare të sektorit sipas kërkesës së palëve, etj., gjithsejtë të arritura – 101 lëndë, prej tyre të aprovuara - 41, në procedurë - 7 dhe të refuzuara - 53.

Puna e Sektorit për Çështje Pronësoro-Juridike është e lidhur edhe me organet tjera si në kuadër të KK Prizrenit si Avokaturën Publike Komunale, Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorinë e Inspektorateve si dhe me organe jashtë KK Prizrenit – Policinë Kosovës, etj.

Paraqitja tabelore e lëndëve

Nr.	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të aprovuara	652
		Të refuzuara	53
		Në procedurë	36
	741	Gjithsej	741

ZYRA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Objektiva e Auditimit të Brendshëm për vitin 2025:

1. Rishikimi periodik dhe vjetor i zbatimit të rekomandimeve

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e Auditorit të Brendshëm dhe Auditorëve nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

2. Realizimi i detyrave audituese sipas Planit të Punës 2025

Në plan janë paraparë gjashtë detyra audituese me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së proceseve me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse si dhe dy raporte për rishikimin e rekomandimeve.

3. Raportimi periodik

Raportim i rregullt për gjashtë mujorin e pare dhe të dytë, për:

- Kryetarin e Komunës,
- Komitetin e Auditimit,

- Njësinë Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

4. Bashkërendimi institucional dhe detyrat këshilluese

Bashkërendimi i aktiviteteve me ekipin e ZKA, me NjQHAB/MFPT, organizimi i takimeve me Komitetin e Auditimit (4 takime të planifikuara) si dhe ofrimi i detyrave këshilluese për drejtoritë komunale.

Rezultatet kryesore/të arritura gjatë periudhës janar – 30 nëntor 2025

Nga gjashtë auditimet e planifikuara për vitin 2025, deri më 30 nëntor janë realizuar pesë auditime, ndërsa një detyrë është në proces dhe pritët të përfundojë gjatë muajit dhjetor, sipas planifikimit vjetor. Gjithashtu, është bërë monitorimi periodik i zbatimit të rekomandimeve në raportet e publikuara.

Auditimet e realizuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2025:

1. Raporti mbi rishikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NjAB për vitin 2024, është dhënë një rekomandim;
2. Rregullsitë në procesin e subvencioneve dhe transfereve, janë dhënë katër rekomandime;
3. Rregullsitë e procesit të planifikimit dhe inkasimi i të hyrave nga taksat komunale, është dhënë një rekomandim;
4. Auditimi i performancës: Menaxhimi dhe ruajtja e pasurisë jo financiare në Administratën komunale, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Arsimit për vitet 2023/2024, janë dhënë pesë rekomandime;
5. Menaxhimi i shpenzimeve për mallra, shërbime dhe komunalitë (Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), janë dhënë tri rekomandime.
6. Pajtueshmëria në proceset e prokurimit mallra, shërbime dhe investime kapitale (Zyra e Prokurimit), janë dhënë katër rekomandime.
7. Menaxhimi i shpenzimeve për investime kapitale (Administrata e Përgjithshme), detyrë audituese në proces.

Aktivitetet e tjera të realizuara nga NjAB gjatë periudhës janar - 30 nëntor 2025

Bashkërendimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA)

- Janë bashkërenduar aktivitetet me ekipin e ZKA-së për periudhat e auditimit të zhvilluara në Komunën e Prizrenit (shkurt - mars dhe nëntor 2025).
- Është siguruar mbështetja e nevojshme dokumentuese dhe procedurale për ekipin e auditimit të jashtëm.

Raportet periodike për rishikimin e rekomandimeve

- Janë hartuar dhe dorëzuar raportet e ecursisë së zbatimit të rekomandimeve për raportet e auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm, për periudhat: **janar, mars, korrik dhe shtator 2025.**

Raportet periodike dhe vjetore për organet përgjegjëse

- Është dorëzuar raporti gjashtëmujor (I) për periudhën janar–qershor 2025 tek:
 - Kryetari i Komunës,
 - Komiteti i Auditimit,
 - NjQHAB (MFPT).

Takimet e Komitetit të Auditimit

- Janë mbajtur tri takime gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, sipas planifikimit.

Pjesëmarrja në projekte dhe aktivitete profesionale

- Pjesëmarrje në takime dhe punëtori të organizuara nga:
 - DEMOS,
 - OSBE,
 - NjQHAB/MFPT.
- Janë ofruar detyra këshilluese dhe mbështetje profesionale për drejtorët dhe zyrtarët komunalë në fushën e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2025 është bërë sigurimi i implementimit për zbatimin e obligimeve të Komunës nga Agjenda Evropiane për veprimet që ndërlidhen me Komunën dhe raportimi sipas kërkesave të MAPLsë.

- Sipas kërkesës së MAPL-së janë mbledhur të gjitha informatat e kërkuara nga secila drejtori në lidhje me zbatimin e obligimeve të Komunës nga Agjenda Evropiane 2025 për PKZMSA (Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit).
- Person përgjegjës në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Forcimi i Qeverisjes në shumë nivele dhe demokracisë me pjesëmarrje”.
- Monitorimi, koordinimi dhe zbatimi i projektit.
- Mbajtja e dy aktiviteteve “Forcimi i qeverisjes shumënivelëshe dhe demokracisë pjesëmarrëse” dhe “Trajnim për qeverisje të hapur lokale”.
- Person përgjegjës në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Autoritete lokale më të forta përmes rritjes së kapaciteteve të asambleistëve dhe zyrtarëve komunalë në Prizren dhe komunat përreth”, u zhvillua punësoria tre ditore e organizuar nga Komuna e Prizrenit – Zyra për Integrime Evropiane në bashkëpunim me Agjencinë Zhvillimore Rajonale Jug (AZHR-Jug), me mbështetje nga Këshilli i Evropës, Kongresi i autoriteteve lokale dhe rajonale ku në aktivitetin e parë morrën pjesë gratë asambleiste nga të gjitha subjektet politike të cilat do të përfaqësohen në Kuvendin Komunal të Prizrenit si dhe zyrtarët komunalë nga sektorë të ndryshëm. Ndërsa në aktivitetin e dytë morrën pjesë gratë asambleiste dhe zyrtarët komunalë të 6 komunave të rajonit (Prizren, Dragash, Mamushë, Malishevë, Rahovec dhe Suharekë).
- Person përgjegjës për të monitoruar trendin e lëvizjes së migrimit pas hyrjes në fuqi të udhëtimit pa viza në BE.
- Mbledhja e të dhënave të kërkuara dhe raportimi në MAPL.
- Anëtare e Komisionit Komunal për Riintegrim.
- Janë mbajtur takimet sa herë që ka pasur kërkesë nga personat e riintegruar.
- Në takime është bërë shqyrtimi i kërkesave të paraqitura nga ana e ZKK-së. Pas shqyrtimit të kërkesave është bërë verifikimi i çdo kërkesë të personave të riatdhesuar përmes ZKK-

së, pastaj është rekomanduar në Zyrën Komunale të Gjendjes Civile dhe është proceduar në Komisionin Komunal për Riintegrim.

- Anëtare e Përhershme e Kolegjiut për Integritime Evropiane.
- Takim i Kolegjiut të Integritimeve Evropiane.
- Plani i vitit 2025 - Miratimi i Planit të Punës.
- Janë mbajtur takime me Grupin Punues për monitorimin dhe raportimin lidhur me zbatimin e Planit Komunal për Integritet.
- Pjesëmarrja në sesione informuese për thirrjet e programeve të BE-së.

ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Gjatë vitit 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) ka ushtruar funksionet e saj në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Prizrenit, me qëllim të integritit të komuniteteve jo-shumicë, përmirësimit të kushteve socio-ekonomike, mbështetjes së kthimit të personave të zhvendosur si dhe forcimit të qëndrueshmërisë, sigurisë dhe bashkëjetesës në komunë.

Ngritja e mirëqenies sociale

Gjatë vitit 2025 janë realizuar një sërë aktiviteteve humanitare dhe sociale në bashkëpunim me organizata partnere. Janë shpërndarë pako ushqimore për 100 familje gjatë muajit të Ramazanit si dhe veshmbathje për 75 familje nga komunitetet boshnjak, turk, rom, ashkali e egjiptian. Për festën e Kurban Bajramit kanë përfituar 300 familje nga shpërndarja e mishit për raste skamnore.

- Në kuadër të thirrjes publike për pako ushqimore dhe higjienike, kanë aplikuar 642 familje, prej të cilave 355 kanë përfituar, ndërsa për dru zjarri për ngrohje kanë aplikuar 652 familje – kanë përfituar 354 familje nga komunitetet jo-shumicë. Janë trajtuar 22 ankesa, të gjitha të refuzuara pas shqyrtimit nga komisioni përkatës.
- Në fushën e banimit dhe strehimit nga Ministria për Komunitete dhe Kthim janë ndërtuar 4 shtëpi banimi, përkatësisht 2 për komunitetin serb dhe 2 për komunitetin rom.

Kthimi dhe riintegrimi

Gjatë vitit janë pranuar 5 kërkesa për kthim të personave të zhvendosur, ndërsa Komisioni Komunal për Kthim ka shqyrtuar 11 kërkesa, prej të cilave 6 janë aprovuar. Janë realizuar 2 vizita informuese “Shko Informo” në Serbi, ku janë vizituar 31 familje, me qëllim informimin mbi procedurat e kthimit. Në fushën e riintegritimit, janë pranuar 15 kërkesa, prej të cilave 13 për vazhdim akomodimi dhe 2 për herë të parë, të shqyrtuara në 7 takime të KKR-së.

Qëndrueshmëria, siguria dhe shërbimet

ZKKK-ja ka marrë pjesë rregullisht në punën e KKS-së, ka ndjekur proceset e rehabilitimit të objekteve të dëmtuara nga zjarri në fshatin Novakë dhe ka ofruar shërbime transporti për komunitetet në linjën Novakë–Prizren–Novakë. Në fushën e shëndetësisë janë lëshuar 550 vërtetime për shërim jashtë vendit.

Bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar

Gjatë vitit 2025, ZKKK-ja ka bashkëpunuar ngushtë me OSBE, UNHCR, UNMIK, IOM, AT dhe organizata të tjera. Në bashkëpunim me IOM-in janë përgatitur tre kabinete shkollore dhe 1 plan biznesi, nga të cilat kanë përfituar 4 persona nga komunitetet jo-shumicë. Po ashtu, është finalizuar dhe miratuar Plani Lokal i Veprimit për gjithëpërfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2025–2028, i cili është zotuar të buxhetohet për vitin 2026.

Përfundim

Në tërësi, gjatë vitit 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet jo-shumicë, forcimin e integritimit social, avancimin e kthimit dhe riintegritimit si dhe në rritjen e bashkëpunimit institucional dhe ndërkombëtar në Komunën e Prizrenit.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtoria për Shërbimeve Publike gjatë vitit 2025, bazuar në planifikimin buxhetor dhe planit të punës, ka paraparë një mori projektsh të reja (rreth 20 projekte), përveç atyre ekzistuese që janë në implementim - rreth 60 projekte që vazhdojnë nga vitet paraprake.

Projektet që do të realizohen dhe që janë në realizimin i përkasin të gjithë sektorëve që janë të Drejtorisë - projekte për ndërtim të rrugëve, kanalizimeve, ujësjellësve, urave, mureve mbrojtëse, parqeve, trotuareve, ndriçimit publik, pastrimit të qytetit. Janë edhe një mori kërkesash nga qytetarët e Komunës që pritet të realizohen me pozicionin e projekteve të vogla infrastrukturore.

Për këtë vit Drejtoria e Shërbimeve Publike ka paraparë buxhet për Investime Kapitale 13,548,699 € nga të cilat mjete nga granti qeveritar janë 10,182,407 € dhe 3,366,292€ nga të hyrat vetanake.

Në kategorinë M&SH për drejtorinë është paraparë buxhet në vlerë prej 5,237,439 €.

Përveç këtij buxheti nga të hyrat e bartuara nga viti 2024, DSHP-ja ka përfitur në fondin në vlerë prej 654,444.91 €. Nga ky buxhet pritet të shpenzohen mjete financiare për 10 projekte, ku shumica e projekteve janë obligime kontraktuale.

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Shërbime Publike ka nënshkruar 37 kontrata të reja në vlerën prej 35,518,164.52 euro.

Në Periudhën Janar – Maj për investime kapitale janë shpenzuar rreth 13,948,848.27 € për kategorinë ekonomike të Investimeve dhe 5,078,628.50 € për kategorinë mallra dhe shërbime.

Disa prej projektet më të rëndësishme në realizim ose të përfunduara infrastrukturore:

- Ndërtimi i kanalizimit të hapur, mureve mbrojtëse dhe rregullimi i rrugicave në fshatin Krushë e Vogël;
- Pastrimi i pushtave dhe ujëmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit;
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit në qytetin e Prizrenit dhe në fshatrat e Prizrenit;

- Pastrimi i pusetave dhe ujëmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit - projekt trevjeçar;
- Rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në pjesët kryesore të qytetit: Shadërvan, Ortakoll, Bajram Curr, Arbanë, etj.;
- Ndërtim i infrastrukturës në fshatin Vlashnje - projekt trevjeçar. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe nëntokësore (ndërtimi i kanalizimit);
- Ndërtimi i infrastrukturës (rrugë, kanalizim, ujësjellës dhe ndriçim publik) në lagjen 11 Marsi;
- Ndërtimi i trotuarit në Vlashnje nga shkolla deri te nënkalimi;
- Ndërtimi i rrugës transitore - kryqëzimi me autostradën në Prizren - projekt dy vjeçar;
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën Nëna Terezë në Prizren - projekt dyvjeçar;
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Zhur;
- Ndërtimi i ujësjellësit dhe rezervuarit në fshatin Lubizhdë e Prizrenit - projekt dyvjeçar;
- Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve me kubza;
- Rehabilitimi dhe rindërtimi i rrugëve me kubza, troutareve dhe shesheve në lagjet Ortakoll, Bajram Curri, Arbanë, Jeta e Re, etj.;
- Rregullimi i infrastrukturës në lagjen Dardania 2 (projekt 2 vjeçar) - Lot 2 dhe Lot 3;
- Rregullimi i infrastrukturës në lagjen Dardania 2 (projekt 2 vjeçar) - Lot 1;
- Ndërtimi i infrastrukturës te shkolla e Dardanisë;
- Aneks kontratë për rregullimin e infrastrukturës në lagjen Dardania 2 - Lot 1;
- Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Vërmicë;
- Ndërtimi me asfalt i rrugës dhe murit mbrojtës në Manastiricë;
- Ndërtimi i infrastrukturës në Tupec;
- Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt – kontratë kornize;
- Ndërtimi, riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me asfalt në Komunën e Prizrenit;
- Instalimi dhe riparimi i ndriçimit publik në lagjet Ortakoll, Bajram Curri, Tusus, Arbanë, Jeta e re dhe në fshatrat Piranë, Zhur, Hoqë e Qytetit dhe në lokalitete të tjera;
- Mirëmbajtja e shtyllave elektrike të ndriçimit publik;
- Ndërtimi i infrastrukturës në Korishë;
- Ndërtimi i rrugës alternative Lubizhdë – Skorobisht;

- Rekonstruimi i rrugës Ekrem Rexha – Drini në fshatin Lubizhdë e Prizrenit;
- Ndërtimi i tregut të gjelbër dhe parkingut nëntokësor në Prizren;
- Ndërtimi i infrastrukturës në Gjonaj;
- Ndërtimi i infrastrukturës në Grazhdanik - rrugët dhe kanalizimi;
- Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen Bajram Curri;
- Ndërtimi i infrastrukturës në Kobajë - rrugë dhe kanalizim;
- Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave në zonën e parë të mbrojtur, kryesisht në pjesën e vjetër të qytetit të Prizrenit.
- Hapja e rrugës pyjore - udha e staneve në Vërmicë;
- Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit;
- Ndërtimi i rrugës nga shkolla në Novoselan deri në Vërbiçan.
- Etj.

Spektori i Menaxhimit të Mbeturinave dhe Mjedisit gjatë këtij viti ka nënshkruar tri kontrata të reja, pasi kontratat e mëparshme kishin skaduar. Meqenëse shërbimet e Sektorit të Mjedisit dhe Mbeturinave mbulojnë disa fusha, ato janë ndarë në kontrata për shërbime dhe kontrata pune.

Kontrata për shërbime të rregullta

Këto janë kontrata që mbulojnë mirëmbajtjen e qytetit, duke përfshirë:

- Pastrimin e rrugëve dhe hapësirave publike;
- Menaxhimin e mbeturinave, përfshirë grumbullimin dhe transportimin e tyre;
- Shërbime rutinë që sigurojnë mirëmbajtje të vazhdueshme të ambientit.

Kontrata për projekte të veçanta

Këto janë angazhime të përkohshme që synojnë përmirësimin dhe trajtimin e veçantë të hapësirave publike që përfshijnë:

- Rehabilitime të hapësirave të gjelbra në zona urbane dhe rurale;
- Projekte të veçanta për trajtimin e mbeturinave.




Aktivitetet dhe fushata mjedisore

Kjo kategori përfshin aktivitetet që rrisin ndërgjegjësimin dhe që promovojnë mbrojtjen e mjedisit, sikurse:

- Fushatat për pastrimin të hapësirave publike;
- Mbjelljen e pemëve dhe krijimin e hapësirave të reja të gjelbra;
- Edukimi dhe promovimi i menaxhimit të duhur të mbeturinave me qytetarë.
- Projekte ambientale në qytet - Ndërtimi dhe rehabilitimi i miniparqeve në lagjen Lakuriq, Bazhdarhane, lagjen Ortakoll dhe lagjen Katër Kullat;
- Implementimi i projektit “Vrapuesja e Prizrenit” – Bazhdarhane;
- Zhvillimi i databazës dhe sistemit Eeb Gis për shërbimet publike në Komunën e Prizrenit;
- Ofrimi i shërbimeve profesionale të konsulencës në fushën e planifikimit strategjik dhe të zhvillimit;
- Ndërtimi i shtratit të Lumbardhit nga ura afër kampusit universitar në vazhdim të rrjedhës - projekt trevjeçar;
- Mirëmbajtja dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Komunën e Prizrenit.
-

Më poshtë gjeni në fotografi të punimeve në terren:











DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Administratës ka luajtur rol qendror në funksionimin e përditshëm institucional të Komunës së Prizrenit, duke ofruar shërbime administrative, financiare, teknike dhe logjistike për qytetarët, drejtoritë komunale dhe institucionet vartëse. Veprimtaria e Drejtorisë është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke synuar efikasitet, transparencë dhe rritje të cilësisë së shërbimeve publike.

Administrata e përgjithshme dhe menaxhimi financiar

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Administratës ka menaxhuar një buxhet të përgjithshëm prej 1,161,099.00 eurove, i ndarë në mallra dhe shërbime si dhe investime kapitale. Investimet kapitale kanë arritur vlerën 410,420.00 euro, ku përfshihen:

- 150,000.00 € për blerjen e veturave për nevojat e Komunës;
- 100,000.00 € për ndërtimin e Memorialit në Krushë të Vogël;
- 100,000.00 € mjete të bartura për blerje veturash zyrtare.

Në kuadër të mallrave dhe shërbimeve janë realizuar shpenzime në vlerë 476,262.04 euro, ndërsa shpenzimet komunale (energji elektrike, ujë, telefon) kanë arritur 205,805.60 euro. Të hyrat e realizuara nga Drejtoria e Administratës për periudhën janar–tetor 2025 kapin shumën 326,438.98 euro apo 68.72% të planifikimit vjetor.

Gjatë periudhës qershor–nëntor 2025 janë përgatitur dhe proceduar dhjetëra lëndë për pagesa, tenderë dhe furnizime, duke përfshirë pastrimin e objekteve, sigurimin, furnizimin me pelet dhe dru, shërbime informimi e furnizime teknike.

Shërbimet administrative dhe ekspedita

Në periudhën qershor–nëntor 2025, zyra ekspeditive e Komunës ka trajtuar një volum të lartë dokumentesh:

- 903 lëndë të shpërndara nëpër drejtori;
- 986 lëndë të dërguara jashtë institucionit;
- 306 lëndë të shpërndara në fshatra;
- 484 lëndë të dorëzuara në gjykata;

- rreth 2,000 dërgesa postare (pranim–dorëzim).

Gjithashtu, për periudhën 01.06.2025 – 27.11.2025, Drejtoria ka shqyrtuar 85 lëndë administrative, prej të cilave 66 janë në proces, 16 të miratuara, 2 të refuzuara dhe 1 e ceduar.

Spektori i Gjendjes Civile

Spektori i Gjendjes Civile ka ofruar një numër të madh shërbimesh për qytetarët gjatë vitit 2025. Janë lëshuar gjithsej 80,290 certifikata, përfshirë:

- 39,084 ekstrakte të lindjes,
- 16,828 certifikata lindjeje,
- 7,997 certifikata martesë,
- 4,176 certifikata vdekjeje,
- 4,610 certifikata vendbanimi,
- 1,840 certifikata shtetësie.

Janë realizuar gjithsej 4,368 shërbime me procedurë, përfshirë regjistrime lindjesh, martesash, vdekjesh dhe vendime për korrigjime dhe regjistrime suplementare. Po ashtu janë regjistruar 73,657 adresa të vendbanimit, si në sistemin e ZGJC ashtu edhe në platformën e-Kosova.

Teknologjia Informative (IT)

Gjatë periudhës janar – qershor 2025 janë realizuar mbi 450 intervenime teknike, përfshirë:

- 130 formatizime dhe instalime të sistemeve operative;
- 90 hapje përdoruesish dhe e-mail zyrtar;
- 75 konfigurime të kompjuterëve të rinj dhe integrim në domenin qeveritar;
- 50 përditësime në uebfaqe, intranet dhe platforma komunale;
- Mbështetje për zyrtarët komunalë dhe institucionet me mungesë staf IT.

Spektori i Teknologjisë Informative ka qenë shtyllë kyçe në mbështetjen e punës administrative dhe digjitale të Komunës. Gjatë periudhës qershor–nëntor 2025 janë realizuar:

- 85 formatizime dhe instalime të sistemeve operative;
- 75 hapje të përdoruesve dhe e-mail-eve zyrtare;

- 153 intervenime në serverë dhe rrjet;
- 70 instalime të kompjuterëve dhe pajisjeve të reja;
- 230 ndërhyrje në uebfaqe, intranet dhe sisteme elektronike;
- 65 instalime printerësh dhe 35 mbështetje teknike për institucione tjera.

Mbështetja logjistike dhe infrastruktura

Drejtorja ka realizuar furnizimin me dru dhe pelet për të gjitha objektet komunale, mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve, sigurimin fizik si dhe mbështetjen logjistike për organizimin e epopeve, përvjetorëve dhe aktiviteteve zyrtare. Janë blerë 7 automjete të reja zyrtare me vlerë rreth 153,000 euro, ndërsa 5 automjete jashtë përdorimit janë planifikuar për ankand.

Barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut

Në kuadër të Drejtorisë, Njësia për Barazi Gjinore dhe të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar aktivitete të shumta ndërgjegjësuëse dhe trajnuese. Është botuar gazeta komunale “Barazia në Fokus”, janë organizuar trajnime për zyrtarë komunalë dhe nxënës si dhe janë zhvilluar punëtori e takime në bashkëpunim me UN Women, UNFPA, UNDP dhe partnerë të tjerë vendorë e ndërkombëtarë.

Përfundim

Gjatë vitit 2025, Drejtorja e Administratës ka dëshmuar kapacitete të qëndrueshme profesionale në ofrimin e shërbimeve administrative, financiare dhe teknike, duke kontribuar drejtpërdrejt në funksionimin efikas të Komunës së Prizrenit dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

DREJTORIA PËR EMERGJENCË DHE SIGURI

Gjatë vitit 2025, Drejtorja për Emergjencë dhe Siguri ka qenë një nga shtyllat kryesore të garantimit të sigurisë publike dhe reagimit institucional ndaj rreziqeve, fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të ndryshme në territorin e Komunës së Prizrenit. Aktivitetet e Drejtorisë janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, me fokus në parandalim, reagim të shpejtë dhe rritje të kapaciteteve operative të shërbimeve të emergjencës.

Projektet dhe investimet

Gjatë vitit 2025 janë realizuar dhe avancuar projekte të rëndësishme për forcimin e infrastrukturës së sigurisë publike, përfshirë:

- Vendosjen dhe mirëmbajtjen e kamerave të sigurisë në qytetin e Prizrenit, përfshirë fazën e dytë përgjatë unazës së qytetit dhe segmentin nga Qafa e Kishës deri te qendra tregtare Elkos;
- Blerjen e një droni për Brigadën e Zjarrfikësve, për monitorim të zonave të rrezikuara dhe mbështetje në intervenime;
- Furnizimin me pajisje operative për Brigadën e Zjarrfikësve;
- Blerjen e uniformave të reja për Shërbimin e Zjarrfikësve;
- Ndërtimin e mureve mbrojtëse në zona të prekura nga rrëshqitjet e dheut, me qëllim mbrojtjen e banorëve dhe infrastrukturës.

Këto investime kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve parandaluese dhe reagimit të shpejtë institucional.

Intervenimet nga Brigada e Zjarrfikësve

Gjatë vitit 2025, Brigada e Zjarrfikësve ka realizuar një numër të madh intervenimesh në shërbim të qytetarëve dhe institucioneve:

- Zjarre të shuara gjithsej 588 raste;
- Intervenime teknike (aksidente, ndihmë teknike, hapje objektesh, etj.) 155 raste;
- Verifikime teknike të sigurisë, përfshirë kontrollin e hidrantëve dhe ashensorëve në objekte publike dhe private si Spitali Rajonal, shkolla, institucione publike dhe qendra tregtare.

Drejtoria, në koordinim me Brigadën e Zjarrfikësve, ka ofruar reagim të menjëhershëm dhe profesional në raste emergjente dhe fatkeqësi natyrore.

Aktivitetet e Inspektorëve të Preventivës

Inspektorët e Preventivës gjatë vitit 2025 kanë qenë të angazhuar në inspektime dhe veprime parandaluese për rritjen e sigurisë:

- Pëlqime për kushte të sigurisë: 38 raste;

- Hulumtime në kushte minimale teknike: 4 raste;
- Hulumtime me përpilim të procesverbaleve: 3 raste;
- Hulumtime dhe inspektime të zjarreve: 18 raste;
- Zjarre të inspektuara dhe të evidentuara: 7 raste;
- Këto aktivitete kanë kontribuar në parandalimin e rreziqeve dhe përmirësimin e standardeve të sigurisë në objekte publike dhe private;
- Menaxhimi i emergjencave dhe bashkëpunimi institucional;

Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri gjatë vitit 2025 ka qenë e përfshirë edhe në:

- Menaxhimin e rasteve të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera;
- Koordinimin me institucionet komunale, policinë, shërbimet shëndetësore dhe akterë të tjerë relevantë;
- Monitorimin e vazhdueshëm të situatave me rrezik potencial për qytetarët dhe infrastrukturën.

Përfundim

Gjatë vitit 2025, Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri ka dëshmuar përkushtim të lartë profesional, kapacitete operative dhe reagim të shpejtë në mbrojtje të jetës, pronës dhe sigurisë së qytetarëve të Komunës së Prizrenit. Investimet në infrastrukturë, pajisje dhe teknologji, së bashku me angazhimin e vazhdueshëm të shërbimeve të emergjencës, kanë kontribuar në rritjen e nivelit të sigurisë publike dhe gatishmërisë institucionale.

DREJTORIA PËR EKONOMI DHE FINANCA

Drejtoria për Ekonomi dhe Financa është përgjegjëse për planifikimin, menaxhimin, realizimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit komunal si dhe për administrimin e të hyrave vetanake dhe shpenzimeve publike. Gjatë vitit 2025, veprimtaria e Drejtorisë është zhvilluar në përputhje me legjislacionin financiar në fuqi, duke siguruar stabilitet fiskal, transparencë dhe disiplinë buxhetore.

Drejtoria funksionon përmes katër sektorëve: Sektori për Buxhet dhe Thesar, Sektori i Financave, Sektori për Tatim në Pronë dhe Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve.

Buxheti dhe Thesari

Gjatë periudhës janar–nëntor 2025, Sektori për Buxhet dhe Thesar ka realizuar:

- 3,049 pagesa të ekzekutuara,
- 1,274 zotime për pagesë,
- 1,669 pranime të mallit në SIMFK,
- 2,641 aprovime të mjeteve të zotuara,
- 1,669 pranime dhe aprovime të faturave.

Ky sektor ka luajtur rol kyç në zbatimin korrekt të buxhetit, përpunimin e pagesave dhe monitorimin e vazhdueshëm të zotimeve financiare.

Të hyrat vetanake komunale

Për periudhën janar–nëntor 2025, Komuna e Prizrenit ka realizuar të hyra vetanake në vlerë prej 10,752,441.18 euro, kundrejt planifikimit prej 10,600,777.00 euro, që përfaqëson 101.43% realizim.

Rritje e theksuar është shënuar në disa drejtori, përfshirë:

- Shërbimet Publike, Mbrojtjen Civile dhe Emergjencat – 118.32% realizim,
- Planifikimin Urban dhe Mjedisin – 122.39% realizim,
- Shërbimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor – 102.05% realizim.

Këto rezultate dëshmojnë menaxhim efikas të të hyrave dhe përmirësim të disiplinës fiskale.

Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet totale për periudhën 01.01.2025 – 30.11.2025 kanë arritur vlerën 65,505,626.50 euro, apo 88.66% e planifikimit vjetor, sipas kategorive:

- Pagat: 24,599,653.54 € (85.58%),
- Mallrat dhe Shërbimet: 13,458,483.95 € (93.24%),
- Shpenzimet Komunale: 1,024,628.52 € (94.95%),
- Subvencionet: 4,291,289.76 € (91.27%),
- Shpenzimet Kapitale: 22,131,570.73 € (88.78%).

Menaxhimi i shpenzimeve është realizuar në mënyrë të kontrolluar, duke ruajtur balancën ndërmjet nevojave operative dhe investimeve kapitale.

Tatimi në Pronë

Spektori për Tatim në Pronë gjatë periudhës janar–nëntor 2025 ka:

- shpërndarë 33,757 fatura për tatimpaguesit,
- realizuar të hyra prej 2,709,494.97 euro,
- regjistruar 2,307 objekte të reja,
- verifikuar 17,202 objekte ekzistuese,
- pranuar dhe shqyrtuar 906 ankesa për pronën e paluajtshme.

Ky sektor ka qenë aktiv në përmirësimin e të dhënave kadastrale dhe rritjen e efikasitetit në arkëtimin e tatimit në pronë.

Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve

Gjatë periudhës janar–nëntor 2025, Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve ka ofruar gjithsej 2,461 shërbime, përfshirë:

- 847 regjistrime të reja,
- 601 ndryshime,
- 87 shuarje të bizneseve,
- 709 informata për biznese,
- 89 duplikate,
- 42 vërtetime,
- 75 ndërrime certifikatash (NUI).

Kjo dëshmon një dinamikë të lartë ekonomike dhe kërkesë të shtuar për shërbime administrative ndaj bizneseve.

Përfundim

Gjatë vitit 2025, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa ka dëshmuar kapacitete të qëndrueshme profesionale në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit komunal, rritjen e të hyrave vetanake dhe kontrollin e shpenzimeve publike. Realizimi mbi 100% i të hyrave të planifikuara dhe niveli i lartë i ekzekutimit buxhetor përbëjnë bazë të fortë për stabilitet financiar dhe zhvillim të qëndrueshëm të Komunës së Prizrenit.

DREJTORIA E INSPEKTORATEVE

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Inspektorateve ka ushtruar përgjegjësitë e saj ligjore në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fusha të ndryshme të jetës publike, ekonomike dhe urbane në Komunën e Prizrenit. Veprimtaria inspektuese është zhvilluar në përputhje me Planin Vjetor të Punës, aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimet e Kryetarit të Komunës, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, sigurinë e qytetarëve, ruajtjen e rendit urban dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Drejtoria ka vepruar përmes sektorëve përkatës: Sektori i Tregut, Sektori Komunal dhe Mjedisor, Sektori i Ndërtimit dhe Inspektorati i Komunikacionit, duke bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Kosovës, Prokurorinë, QRTK-në, drejtoritë komunale dhe institucionet tjera relevante.

Sektori i Tregut – Mbrojtja e konsumatorit dhe siguria e produkteve

Sektori i Tregut gjatë vitit 2025 ka zhvilluar veprimtari intensive inspektuese me fokus në mbrojtjen e konsumatorit dhe rritjen e standardeve të tregtimit. Janë realizuar mbi 620 inspektime në biznese të ndryshme tregtare dhe hoteliere, përfshirë qendra tregtare, dyqane zejtare, furrat e bukës, barnatore, kiosqe dhe tregje të hapura.

Fokuset kryesore të inspektimeve kanë qenë:

- verifikimi i çmimeve dhe përputhshmëria ndërmjet rafteve dhe arkës;
- kontrolli i peshës dhe cilësisë së produkteve ushqimore, veçanërisht në furrat e bukës;
- verifikimi i etiketimit, deklaracioneve dhe dokumentacionit në gjuhën shqipe;
- kontrolli i origjinës, afatit të përdorimit dhe sigurisë së produkteve;

- mbikëqyrja e ndalimit të shitjes së duhanit, alkoolit dhe pijeve energjike për persona nën moshën 18 vjeç;
- trajtimi i reklamacionit dhe ankesave të konsumatorëve.

Gjatë vitit janë trajtuar 26–30 ankesa të konsumatorëve, janë realizuar 597 kontrolle me procesverbal, 87 aktvendime, 105 pëlqime teknike minimale, 24 kërkesa për kundërvajtje dhe 5 ndalime të veprimtarisë. Si rezultat i shkeljeve të konstatuara, janë shqiptuar gjoba në vlerë mbi 5,300 euro, ndërsa është bërë asgjësimi i produkteve të pasigurta në vlerë mbi 58,000 euro, përfshirë mallra me afat të skaduar ose pa dokumentacion përkatës.

Sektori Komunal dhe Inspektorati i Mjedisit

Sektori Komunal ka qenë i angazhuar në mbikëqyrjen e rendit urban dhe shfrytëzimit të hapësirave publike. Janë realizuar inspektime të rregullta në rrugë, trotuare, sheshe dhe tregje, me qëllim lirim të hapësirave të uzurpuara dhe rregullimin e qarkullimit të lirë të qytetarëve.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar:

- 373 procesverbale,
- 13 aktvendime,
- urdhër-ekzekutime,
- 60 njoftime dhe raporte,
- 17 kallëzime penale,
- gjoba mandatore në vlerë 1,400 euro.

Janë realizuar ekzekutime konkrete për lirim të rrugëve dhe hapësirave publike në qytet dhe fshatra si Reçan, Bazhdarhane, Atmaxhe, Shën Flori dhe Pouskë. Sektori ka asistuar Drejtorinë e Urbanizmit në shenjëzimin dhe rregullimin e hapësirave publike në Qendrën Historike të Prizrenit. Inspektorati i Mjedisit ka monitoruar zbatimin e lejeve mjedisore, ka inspektuar operatorin Eco-Regjioni, ka urdhëruar largimin nga përdorimi të mjeteve që shkaktojnë ndotje dhe ka shqiptuar gjoba për hedhje ilegale të mbeturinave, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Inspektori i Komunikacionit

Inspektori i Komunikacionit ka ushtruar kompetencat ligjore në mbikëqyrjen e transportit publik të udhëtarëve dhe transportit të mallrave. Janë kryer inspektime të rregullta në linjat e transportit publik, taksitë dhe autobusët ndërrurbanë. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë inspektuar vendqëndrimet e taksive dhe operatorët ekonomikë që nuk kanë respektuar përdorimin e Stacionit të Autobusëve të Prizrenit, ndaj të cilëve janë ndërmarrë masa ligjore.

Sektori i Ndërtimit – Mbikëqyrja e rendit ndërtimor

Sektori i Ndërtimit ka qenë një nga sektorët më të ngarkuar gjatë vitit 2025. Janë trajtuar 408 kërkesa dhe ankesa të qytetarëve, të pranuar përmes shkresave zyrtare, e-mailit, linjave telefonike dhe rrjeteve sociale.

Gjatë vitit janë realizuar:

- 321 procesverbale,
- 72 aktvendime,
- 31 gjoba mandatore,
- urdhër-ekzekutime,
- 6 ekzekutime,
- 28 kallëzime penale.

Vlera e përgjithshme e gjobave mandatore ka qenë 28,000 euro, prej të cilave 10,400 euro janë inkasuar. Sektori ka ndërprerë ndërtime pa leje, ka kontrolluar objektet me leje ndërtimore dhe ka asistuar Policinë e Kosovës dhe institucionet tjera në terren. Pavarësisht mungesës së stafit dhe pajisjeve, inspektimet kanë vazhduar në mënyrë të pandërprerë.

Përfundim

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Inspektorateve ka zhvilluar veprimtari intensive dhe gjithëpërfshirëse inspektuese, duke kontribuar ndjeshëm në mbrojtjen e konsumatorit, ruajtjen e rendit urban, sigurinë publike dhe ligjshmërinë e veprimtarive ekonomike në Komunën e Prizrenit.

DREJTORIA KOMUNALE E SHËNDETËSISË

Drejtoria Komunale e Shëndetësisë gjatë vitit 2025 ka ushtruar përgjegjësitë e saj në planifikimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve, rritjen e qasjes së qytetarëve në kujdes shëndetësor dhe modernizimin e infrastrukturës shëndetësore në Komunën e Prizrenit.

Veprimtaria e DKSH-së është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, politikat shëndetësore kombëtare dhe prioritetet e përcaktuara nga Kryetari i Komunës, duke u fokusuar në investime kapitale, furnizime me mallra dhe shërbime, rritje të kapaciteteve profesionale dhe ofrim efikas të shërbimeve shëndetësore për qytetarët.

Investimet kapitale dhe infrastruktura shëndetësore

Gjatë vitit 2025, DKSH-ja ka realizuar dhe menaxhuar projekte kapitale me rëndësi strategjike për zhvillimin e rrjetit të kujdesit parësor shëndetësor.

Projektet kapitale në vazhdim:

- Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në lokacionin e ish-kampit të KFOR-it;
- Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF) në Lagjen Tusus.

Projektet kapitale të përfunduara gjatë vitit:

- Furnizimi me autoambulanca për nevojat e shëndetësisë primare;
- Furnizimi me mamograf për shërbimet diagnostikuese;
- Blerja e pajisjeve jomjekësore për institucionet e KPSH-së;
- Furnizimi me pajisje laboratorike për QKMF dhe QMF-të.

Gjithashtu, gjatë vitit është realizuar:

- përrurimi i QMF-së së re në Korishë;
- përrurimi i punimeve të renovimit në AMF Skorobisht dhe AMF Lubizhdë e Hasit;
- nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me DPMS-në, për mbikëqyrjen e projekteve ndërtimore të kontraktuara nga DKSH-ja.

Mallrat dhe shërbimet shëndetësore

Në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, DKSH-ja gjatë vitit 2025 ka realizuar një numër të madh furnizimesh dhe shërbimesh mbështetëse për funksionimin e rregullt të institucioneve shëndetësore, përfshirë:

- furnizim me barna dhe materiale sanitare;
- furnizim me reagenca laboratorike dhe filma rentgen;
- furnizim me material stomatologjik;
- furnizim me materiale higjienike;
- furnizim me uniforma pune për personelin shëndetësor;
- furnizim me inventar për zyra dhe ordinanca;
- sigurim fizik për objektet e KPSH-së;
- mirëmbajtje dhe renovim të objekteve shëndetësore;
- lyerje të brendshme dhe të jashtme të objekteve;
- trajnime për profesionistët shëndetësorë;
- përpunim statistikor i të dhënave nga vizitat sistematike në shkolla;
- hartim i projektit për ndërtimin e Ambulancës së Mjekësisë Familjare (AMF) në fshatin Vlashnje.

Shërbimet shëndetësore të ofruara

Përmes QKMF-së dhe rrjetit të QMF-ve, gjatë vitit 2025 është ofruar një volum shumë i lartë shërbimesh shëndetësore për qytetarët e Komunës së Prizrenit.

- Janar–maj 2025: rreth 385,875 shërbime shëndetësore
- Qershor–nëntor 2025: rreth 454,498 shërbime shëndetësore

Në total për vitin 2025: mbi 840,000 shërbime shëndetësore të ofruara.

Shërbimet përfshijnë: vizita mjekësore specialistike, vaksinime, analiza laboratorike, RTG, shërbime urgjente, shërbime geriatrike dhe paliative, shërbime stomatologjike, vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë, teste rapide, EKG, injeksione, infuzione, inhalime, fashime, këshillime dhe udhëzime shëndetësore.

Gjithashtu, gjatë vitit janë realizuar vizitat sistematike mjekësore në shkolla për nxënësit e klasave I, V dhe IX në tërë territorin e komunës.

Promovimi i shëndetit dhe aktivitetet vetëdijësuese

DKSH-ja ka marrë pjesë aktive në shënimin e Ditëve Botërore të Shëndetit, përmes ligjëratave, fushatave vetëdijësuese, shpërndarjes së fletushkave informative dhe aktiviteteve publike në Sheshin Shadërvan.

Gjatë vitit janë shënuar:

- Dita Botërore e Kancerit
- Dita Botërore e Tuberkulozit
- Java Botërore e Imunizimit
- Dita Botërore e Hipertensionit
- Dita Botërore e Duhanit
- Dita Botërore e Dhurimit Vullnetar të Gjakut
- Java Botërore e Gjdhënies
- Dita Botërore e Zemrës
- Tetori Rozë – Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit
- Dita Botërore e Diabetit



Mbështetja financiare për qytetarët

Në kuadër të zbatimit të rregullores për ndarjen e subvencioneve, gjatë vitit 2025 është realizuar mbështetje financiare për kategori të ndryshme të qytetarëve.

- Janar–maj 2025:
 - 832 kërkesa të pranura
 - 247 kërkesa të paguara në vlerë 98,800 €
 - 187 kërkesa nga viti 2024 të paguara në vlerë 74,800 €

- Qershor–nëntor 2025:

- rreth 335 kërkesa të reja
- 417 pagesa të realizuara për kërkesat e muajve prill–korrik
- vlera totale e pagesave: 166,950 €

Monitorimi, bashkëpunimi dhe donacionet

Gjatë vitit janë realizuar vizita monitoruese në QMF-të në Korishë, Lubizhdë, Romaj dhe qendra të tjera shëndetësore, si dhe në projektet kapitale në ndërtim, shpesh në praninë e Kryetarit të Komunës.

Në muajin maj është përuruar donacion me pajisje mjekësore dhe jomjekësore për QMF Reqan, i dhuruar nga Ambasada e Bullgarisë, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe shërbimeve shëndetësore.

Përfundim

Gjatë vitit 2025, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë ka dëshmuar kapacitete të qëndrueshme profesionale dhe menaxheriale në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, realizimin e investimeve kapitale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës dhe shërbimeve të kujdesit parësor. Volumi i lartë i shërbimeve të ofruara dhe investimet e realizuara përbëjnë bazë të fortë për avancimin e mëtejshëm të shëndetësisë komunale në vitet në vijim.

Më poshtë gjeni në fotografi të punimeve në terren:







DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor gjatë vitit 2025 ka ushtruar përgjegjësitë e saj në planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit hapësinor të Komunës së Prizrenit, duke u fokusuar në rregullimin urban, përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat e banimit kolektiv, hartimin e dokumenteve strategjike të planifikimit dhe ofrimin e shërbimeve administrative cilësore për qytetarët.

Veprimtaria e Drejtorisë është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikim hapësinor, udhëzimet administrative përkatëse dhe objektivat strategjike komunale, me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe rural.

Projektet kapitale dhe dokumentet strategjike të planifikimit

Rehabilitimi i kulmeve dhe korridoreve në objektet e banimit kolektiv

Gjatë vitit 2025, Drejtoria ka vazhduar me realizimin e projektit për rehabilitimin e kulmeve dhe korridoreve në objektet e banimit kolektiv. Është përzgjedhur lista e objekteve përfituese dhe punimet janë futur në fazën e ekzekutimit.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është:

- përmirësimi i kushteve të jetesës për banorët;
- rritja e sigurisë dhe funksionalitetit të objekteve;
- përmirësimi i pamjes urbanistike të lagjeve me banim kolektiv.

Ky projekt përbën një ndër investimet më të rëndësishme komunale në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të banimit.

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK)

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) është një nga proceset më strategjike dhe afatgjata të Drejtorisë. Gjatë vitit 2025:

- është përfunduar faza e diskutimit publik për Profilin Urban;
- procesi ka vazhduar në përputhje me kornizën ligjore dhe udhëzimet administrative për planifikim hapësinor;
- pritet konfirmimi për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) nga MMPHI.

PZHK do të përcaktojë:

- zonimin e zhvillimit urban dhe rural;
- drejtimit e zgjerimit të qytetit;
- mbrojtjen e hapësirave të gjelbra dhe trashëgimisë kulturore;
- balancimin ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë mjedisore.

Plani Rregullues Urban për Zonën e Veçantë – Parku i Biznesit

Gjatë vitit 2025 është avancuar dhe përmbyllur procesi i hartimit të Planit Rregullues Urban për Zonën e Veçantë – Parku i Biznesit. Ky plan:

- ka kaluar të gjitha fazat procedurale;
- ka arritur deri në fazën e miratimit përfundimtar.

Plani krijon bazë të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik, tërheqjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të reja të punës në Komunën e Prizrenit.

Shërbimet administrative dhe statistikat e punës (Urbanizmi)

Statistikat: Janar–Qershor 2025

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, në sektorin e Urbanizmit janë trajtuar:

- Lëndë të pranuar: 586
- Njoftime: 60
- Kërkesa të miratuara: 228
- Deklarata, vërtetime dhe shkresa të ndryshme: 50
- Kërkesa të refuzuara: 33
- Kërkesa të hedhura poshtë: 13
- Procedura të pezulluara: 6
- Lëndë në procedurë: 181
- Qasje në dokumente zyrtare: 11
- Ankesa të dërguara në MMPH: 4

Në kuadër të legalizimeve – Task Forca (janar–qershor 2025):

- Legalizime të përfunduara: 134
- Lista e pritjes: 19
- Kërkesa në shqyrtim: 154

Statistikat: Korrik–Nëntor 2025

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025 janë evidentuar këto të dhëna:

- Lëndë të pranuar: 541
- Njoftime: 60
- Kërkesa të miratuara: 243
- Deklarata, vërtetime dhe shkresa të ndryshme: 44
- Kërkesa të refuzuara: 26

- Kërkesa të hedhura poshtë: 13
- Procedura të pezulluara: 19
- Lëndë në procedurë: 127
- Ekstrakte për Prevallë: 4
- Qasje në dokumente zyrtare: 2
- Ankesa të dërguara në MMPH: 3

Në kuadër të legalizimeve – Task Forca (korrik–nëntor 2025):

- Legalizime të përfunduara: 134
- Lista e pritjes: 4
- Lista e rrënimit: 0
- Kërkesa në shqyrtim: 101

Legalizimet dhe Task Forca

Procesi i legalizimeve ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2025 në kuadër të Task Forcës, duke synuar:

- zgjidhjen e ndërtimeve pa leje;
- rritjen e sigurisë juridike për qytetarët;
- përmirësimin e rendit urban dhe hapësinor.

Gjatë vitit janë përfunduar 268 legalizime, ndërsa një numër i konsiderueshëm kërkesash mbeten në shqyrtim, sipas procedurave ligjore në fuqi.

Vlerësim i përgjithshëm dhe sfidat

Drejtorja e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor gjatë vitit 2025 ka përballuar një volum të lartë të kërkesave administrative dhe proceseve komplekse planifikuese. Sfidat kryesore ka qenë:

- rritja e numrit të lëndëve;
- kompleksiteti i dokumenteve strategjike;
- nevoja për koordinim ndërinstitutional në proceset e planifikimit dhe legalizimit.

Pavarësisht këtyre sfidave, Drejtorja ka arritur të ruajë efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve.

Përfundim

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor ka dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin urban dhe hapësinor të Komunës së Prizrenit. Përmes projekteve kapitale, dokumenteve strategjike të planifikimit, procesit të legalizimeve dhe trajtimit efikas të kërkesave administrative, Drejtoria ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren në përputhje me Planin Dinamik të saj për periudhën janar – nëntor 2025 dhe bazuar në planifikimin e sektorëve në DKA mbi detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, ka planifikuar dhe realizuar aktivitete dhe projekte të ndryshme.

Në këtë raport përfshihen punët administrative, monitorimi dhe mbikqyrja e shkollave, shënimi i rekomandimeve për shkollat, shënime të përgjigjeve dhe vendimeve për transferimin e nxënësve të shkollave mesme të larta, organizimin e arsimit joformal, procedurat e ndërtimit të objekteve shkollore, anekseve, riparimeve, mirëmbajtjen e objekteve dhe ambienteve shkollore, projektet që lidhen me sigurinë në shkolla, planifikimin e buxhetit për çdo fillimviti shkollor, shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve etj.

Raporti për periudhën janar – nëntor 2025 është përpiluar nga raportet e aktiviteteve, projekteve të realizuara dhe punë tjera të kryera nga kjo drejtori, gjatë kësaj periudhe. Në këtë raport janë përmbledhur të dhënat e sektorit të arsimit dhe të administratës, punëtoritë e zhvilluara dhe aktivitete të tjera të cilat janë mbajtur.

Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave

Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të Komunës së Prizrenit.

Raporti mbi të arriturat

Në Janar 2025 është mbajtur trajnimi i drejtorëve (7 ditorë) për ngritjen e kapaciteteve për Udhëheqje dhe Menaxhim për të gjithë drejtorët e institucioneve shkollore në Prizren përmes

moduleve nga programe të akredituara nga MASHTI. Për fuqizimin dhe funksionalizimin e Këshillave Drejtues të Shkollave është mbajtur trajnim profesional me KDSH-në, me qëllim të mbështetjes profesionale në mënyrë që kontributi të jetë sa me profesional varsisht nga specifikat e shkollave.

Në maj është mbajtur punëtori me drejtues të shkollave, sekretarë, psikologë e antarë të këshillit të prindërve për “Buxhetimin e Përgjegjshëm gjinor në arsim në Komunën e Prizrenit” me qëllim t’i bëjmë shkollat tona mjedise miqësore, të përshtatshme dhe të sigurt për nxënësit dhe mësime të tjerë si dhe për të gjithë të tjerët.

Në kuadër të projektit “Avancimi i cilësisë së arsimit në Komunën e Prizrenit - Ngritja e kompetencave përmes zhvillimit profesional në fushën e menaxhimit, vlerësimeve, mendimit kritik dhe gjithëpërfshirjes” është realizuar studimi rapid i shkollave - hulumtim profesional i gjendjes aktuale në secilën shkollë duke përfshirë nivelin e menaxhimit, resurset humane, administratën, infrastrukturën, vizionin, raportet ndërkolegiale, organet qeverisëse të shkollës, etj. me qëllim që të kemi skanim real të gjendjes.

Janë hartuar raporte individuale në nivel shkolle dhe raporti përmbledhës në nivel komune si dhe janë dhënë rekomandime konkrete me qëllim të avancimit të arsimit në nivel komune.

Poashtu, me qëllim të menaxhimit dhe efikasitetit nëpër shkolla është bërë rishikimi dhe racionalizimi i rrjetit të klasave në shkolla në Komunë Prizrenit.

Kultura dhe Mjedi

Mjedi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore.

Raporti mbi të arriturat

Nga muaji prill ka hy në fuqi “Strategjia për sigurinë në institucionet edukativo – arsimore” e cila është plan i përbashkët për të garantuar mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për nxënësit, mësuesit dhe stafin arsimor. Kjo strategji synon të parandalojë rreziqet, t’i minimizojë incidentet dhe të promovojë një kulturë të mirëqenies në shkollë.

Gjatë gjithë vitit ka vazhduar puna me ndërtimin e terreneve dhe sallave të edukatës fizike në shkolla dhe furnizimi me pajisje edukativo-sportive. Poashtu, është punuar edhe në rregullimin e

ambienteve të jashtme të shkollave për të ofruar mjedis shkollor sa më të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore.

Mësimdhënia dhe nxënia

Përmirësim domethënës i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies në shkolla.

Raporti mbi të arriturat

DKA-ja, në bashkëpunim me shkollat dhe OJQ-të që merren me arsimin, ka punuar në fuqizimin e modelit “komuniteti i të mësuarit së bashku”. Shkollat janë furnizuar me mjete të TIK-ut nga DKA-ja dhe me mjete elementare të konkretizimit nga bashkëpuntorët e arsimit. Gjatë vitit ka vazhduar pajisja e shkollave me laboratorë të ndryshëm të cilët ndikojn drejtpërdrejt në efektivitet të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Organizimi i mësimin plotësues dhe trajnimeve për nxënësit ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në arsim. DKA-ja, në bashkëpunim me Flutura Academy dhe OJQ-të që merren me fushën e arsimit, po vazhdon mbajtjen e trajnimeve për nxënësit në fushën e IT-së dhe gjuhëve të huaja. Gjithashtu, janë mbajtur shumë aktivitete jashtëkurrikulare të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e cilësisë në arsim.

Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit parashkollor.

Raporti mbi të arriturat

Është përgatitur drafti i “Planit të Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjstrimit në Shkollë”, ku së shpejti pritet të del draft dokumenti në dëgjim publik.

Po vazhdon procesi i identifikimit të institucioneve parashkollore private. Janë mbajtur disa takime koordinuese me Inspektoratin e Arsimit, ku janë duke u koordinuar vizitat dhe mbledhja e të dhënave.

Bashkë me agjencitë zhvillimore është duke vazhduar përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. DKA ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Caritas Kosova për ta vazhduar dhënien e shërbimeve profesionale psikologjike për fëmijët me nevoja të veçanta. Gjithashtu, vazhdon bashkëpunimi edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare (UNICEF, SCIK etj.) për t’i përmirësuar shërbimet arsimore për nxënësit në nevojë.

Është funksionalizuar institucioni i edukimit të hershëm “Dielli Ynë” në lagjen Bajram Curri. Jemi në fazën finale të përgatitjeve për hapjen e institucionit për edukim të hershëm në lagjen Ortakoll.

Përmes garave dhe aktiviteteve të tjera ndërkulturore është duke u promovuar multikulturalizmi dhe diversiteti në arsimin parauniversitar.

Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimdhënie cilësore.

Raporti mbi të arriturat

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një nga faktorët kryesorë që ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në arsim. DKA-ja në vazhdimësi ka hulumtuar kërkesat e menaxhmentit udhëheqës të institucioneve edukative e arsimore dhe të mësimdhënësve për zhvillim profesional. Prandaj, nga kërkesat e shkollave është vlerësuar se fillimisht zhvillimi profesional do të orientohet në fushat e menaxhimit, vlerësimit, mendimit kritik dhe gjithëpërfshirjes. Prandaj, më qëllim që mësimdhënësit të jenë sa më të përgaditur, DKA-ja ka organizuar trajnime për 500 mësimdhënës, të ndarë në fushat përkatëse:

- Vlerësimi Formativ – mësimdhënës (7 grupe), Mendimi Kritik – mësimdhënës (4 grupe)
- PIA – mësimdhënës (4 grupe)
- Trajnimet e ofruara janë nga programet e akredituara dhe valide për procesin e licencimit apo rilicendimit të mësimdhënësve.
- Fuqizimi i aktiveve profesionale në shkolla, përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë, ndërtimi, renovimi, zgjerimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës shkollore si dhe furnizimi ka ndikuar dukshëm në përmirësimin e cilësisë në të nxënit.
- Ndërtim i vazhdueshëm i kapaciteteve dhe i mekanizmave për zbatim dhe monitorim të kurrikulës së re.

Është intensifikuar shërbimi i këshillëdhënies për shkollat lidhur me zbatimin e KKK-së. Përmes drejtorëve dhe koordinatorëve të cilësisë shkollat marrin këshilla nga DKA-ja për modalitetet e zbatimit të KKK-së, për sfidat e zbatimit dhe për zgjidhjet e mundshme të problemeve ad-hoc të zbatimit të KKK-së. Gjithashtu, shkollat vazhdimisht furnizohen me materiale pune, me udhërrëfyes dhe dokumentacion relevant për zbatimin e KKK-së.

Meqenëse është duke u shtuar përdorimi i mjeteve digjitale në funksion të mësimdhënies dhe nxënies, shkollat janë furnizuar me tabela të mençura si dhe me paisje teknologjike. Ka filluar faza e parë e digjitalizimit të sistemit arsimor (platformës digjitale).

Me bashkëfinancim me IOM-in tri shkolla janë pajisur me kabinete për fizikë, kimi, biologji, gjeografi - bazuar në nevojat e shkollave.

Me mbështetje nga Super Viva është realizuar projekti i ateliesë së artit figurativ në SHFMU "Mustafa Bakiu" në Prizren.

Për vitin shkollor 2024-2025 Drejtoria Komunale e Arsimit ka rritur numrin e bursave këtë vit nga 170 bursa sa ishte vitin e kaluar në 250 bursa në vlerë prej 700 euro secila.

Poashtu, për vitin shkollor Drejtoria Komunale e Arsimit ka ndarë bursa nga 300 euro për nxënës të shkollave të mesme, për fëmijët e invalidëve të luftës dhe nxënës me nevoja të veçanta.

Të dhënat statistikore

Gjatë vitit shkollor **2025/2026** në institucionet publike të menaxhuara nga Komuna e Prizrenit kanë ndjekur mësimin **26.920** nxënës, të gjitha shkollat publike me paralelet e ndara, në të tri nivelet e arsimit (0, 1, 2 dhe 3) nga edukimi i hershëm (fëmijë të moshave 3-4 vjeç) deri në shkollat e mesme të larta (klasa e 12).

Arsimi i komuniteteve

Në mënyrë periodike takohen drejtorët e shkollave të komuniteteve dhe shkollave në të cilat zhvillohet mësimi edhe në gjuhët e komuniteteve. Një ndër shqetësimet kyçe të këtyre shkollave janë librat mësimorë në gjuhën e komuniteteve, të cilat nuk janë përgatitur me kohë nga MASHTI, gjë që ua vështirësojnë punën mësimdhënësve me nxënësit. Deri në pajisjen me materialet mësimore shkollat janë udhëzuar të përdorin burime alternative nga interneti.

AKTIVITETET:

- 7 Marsi - Është organizuar program artistik nga DKA-ja për nder të Ditës së Mësuesit, ku janë shpërndarë mirënjohje dhe dhurata;
- anë mbajtur Garat Komunale Fizikanti i Ri 2025;

- Është mbajtur testi ndërkombëtar PISA 2025 nga 18 shkolla në Komunën e Prizrenit, ku kanë marrë pjesë 606 nxënës;
- Është mbajtur Testi i Arritshmërisë për vitin shkollor 2024-2025;
- Përgatitja e organizimit të Testit të Maturës për vitin shkollor 2024/2025, i cili është mbajtur më 21 qershor afati parë dhe më 28 gusht 2025 i dyti.
- Vizita në të gjitha shkollat e mesme të larta për të monitoruar dokumentet pedagogjike dhe administrative;

Trajnime, punëtori dhe punë në ekip

- Punëtori për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor 2026-2028;
- Pjesëmarrje në punëtorinë për të drejtat e fëmijëve;
- Takim i komisionit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, pranë Kuvendit Komunal;
- Organizimi i procesit mësimor në mësimin jo formal.
- Mbikëqyrja e planeve të punës dhe procesit edukativo – arsimor, kontrollimi i funksionimit të organeve të shkollës etj;
- Bashkëpunimi me prindër, Ekipet e EPRBM të shkollës, këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve;
- Monitorimi i shkollave për të kontrolluar plotësimin e standardeve për krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës të përshtatshëm të mësimdhënies dhe të nxënësve;
- Vlerësimi i brendshëm i shkollës në shkallë kurrikulare – “Monitorimi i nxënësve të shkollave të Komunës së Prizrenit;
- Kontrollimi i vlerësimit të brendshëm të shkollave;
- Monitorimi i funksionimit të mjeteve teknologjike i shkollave.

Infrastruktura në shkollat e Komunës së Prizrenit

Njësia teknike pranë DKA-së ka vazhduar punët për realizimin e projekteve dhe planifikimin e projekteve të reja, përfshirë furnizimin me mallra dhe dhënie të shërbimeve të shkollave si dhe ka monitoruar punimet (nga investimet kapitale) që janë bërë në ndërtimin e objekteve shkollore.

Janë realizuar aktivitete të ndryshme si vijon:

- Kompletimi dhe dorëzimi i dokumentacionit të inventarizimit të shkollave dhe DKA-së te zyrtarët në Drejtorinë e Financave,

- Vizitat e rregullta nëpër shkolla për verifikimin e pastërtisë dhe higjienës,
- Vizita të rregullta në çerdhen e fëmijëve për të evidentuar kërkesat lidhur me infrastrukturë dhe mallëra,
- Janë mbajtur takimet konsultative me operatorët ekonomikë lidhur me ndërtimin e objekteve shkollore,
- Janë mbikqyrë punimet e projekteve të cilat vazhdojnë nga vitet e kaluara.

Investime kapitale:

- Ndërtimi i qerdhes në lagjen Arbana;
- Digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore;
- Renovimi i objektit shkollos SHMU "Hysen Rexhepi";
- Renovimi i objektit shkollos në fshatin Gjonaj (objekti i vjetër);
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHMU "Gani Saramati" - projekt tre vjeçar;
- Ndërtimi i deposë për lëndë djegëse për ngrohje në SHFMU "Lekë Dukagjini" në Prizren dhe shkollën "Mushnikova" në Mushnikovë;
- Renovimi i tërësishëm i objektit shkollos "Dëshmorët e Zhurit" në Zhur;
- Renovimi i objektit shkollos "Mustafa Baku" në Prizren;
- Ndërtimi i qerdhes në lagjen "Tusus" në Prizren;
- Ndërtimi i objektit të ri shkollos "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" (ish Pjetër Mazrreku) në Mazrrek;
- Ndërtimi i objektit të ri shkollos në Krushë të Vogël;
- Ndërtimi i aneksit të shkollës në Vërmicë;
- Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Ndrecaj" në Lutogllavë;
- Renovimi i objektit shkollos SHF "Lekë Dukagjini" në Prizren;
- Rregullimi i ambientit të oborreve në shkollat e Prizrenit;
- Ndërtimi i qerdhes në fshatin Zhur;
- Renovimi i tërësishëm i objektit të SHFMU "Mati Logoreci" në Prizren;
- Renovimi i nyjeve sanitare në objektet shkollore: Ibrahim Fehmiu dhe Dëshmorët e Kabashit;
- Renovimi i tërësishëm i sallës së edukatës fizike në shkollën "Meto Bajraktari" në Reçan;
- Punimi i terrenit sportiv dhe rrethojës së oborrit në SHFMU "Naim Frashëri" në Kobaj;

- Digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat: Emin Duraku, Mati Logoreci, Lekë Dukagjini, Abdyl Frashëri, Hysen Rexhepi, Gani Saramati, Ibrahim Fehmiu, Fadil Hisari;
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU "Zef Lush Marku" në Velezhë - projekt tre vjeçar;
- Ndërrimi i kalldajave të ngrohjes qendrore në shkollat; SHFMU "Motrat Qiriazhi", "Luigj Gurakuqi" në Nashec dhe "Brigada 125" në Medvec - projekt dy vjeçar;
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHMU "Gani Saramati" - projekt dy vjeçar;
- Ndërtimi i nyjave sanitare dhe tualeteve në shkollën "Sinan Thaqi" në Zojz;
- Në ndërtim e sipër është aneksi i shkollës "Fatmir Berisha" në Prizren;
- Renovimi i tërësishëm i objekti shkollor në Gorozhup;
- Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme në Romajë – Has.

Gjatë vitit 2025 kanë vazhduar nga viti i kaluar edhe këto kontrata/projekte, nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime:

- Hartimi i projekteve të ndryshme për nevojat e DKA-së,
- Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes qendrore nëpër institucionet arsimore të Komunës së Prizrenit,
- Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) e institucioneve arsimore – e planifikuar për tre vjet.

Gjatë vitit 2025, investime kapitale janë të planifikuara gjithsej 27 projekte, disa prej të cilave kanë përfunduar gjatë vitit fundvitit 2024. Vlera totale e planifikuar e investimeve kapitale për vitin 2025 është 2,486,873.00 €

Sipas rrjedhës së punimeve, gjegjësisht realizimit të tyre, deri më 31.05.2025, janë realizuar rreth 34,22%, apo 851,066.61 €.


Gjatë vitit 2025 janë në vazhdim nga viti i kaluar edhe këto kontrata/projekte, nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime si më poshtë:

- Hartimi i projekteve të ndryshme për nevojat e DKA-së,
- Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes qendrore nëpër institucionet arsimore të Komunës së Prizrenit,

- Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) të institucioneve arsimore - projekt tre vjeçar.

Më poshtë gjeni në fotografi të punimeve dhe aktiviteteve në terren:





DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) gjatë vitit 2025 ka ushtruar funksionet e saj në zhvillimin dhe avancimin e jetës kulturore, rinore dhe sportive në Komunën e Prizrenit, duke u fokusuar në investime kapitale, mbështetje financiare për organizata dhe individë si dhe organizimin e aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive me karakter lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Veprimtaria e DKRS-së është zhvilluar në përputhje me politikat komunale, legjislationin në fuqi dhe prioritetet strategjike të Kryetarit të Komunës, me synim ruajtjen e trashëgimisë kulturore, rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe promovimin e Prizrenit si qendër kulturore dhe sportive.

Projektet kapitale dhe infrastruktura kulturore, rinore dhe sportive

Gjatë vitit 2025, DKRS-ja ka realizuar dhe menaxhuar një numër të konsiderueshëm projektesh kapitale, të cilat janë monitoruar në vazhdimësi nga stafi përgjegjës i Drejtorisë.

Projektet e përfunduara gjatë vitit 2025:

- Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur (punimet kanë përfunduar);
- Ndërtimi i zhveshtoreve të stadiumit në fshatin Gjonaj;
- Inventarizimi i objekteve kulturore, rinore dhe sportive;

- Përfundimi i fazës së parë të mbështetjes financiare për OJQ-të dhe individët, me vlerë totale 1,337,800 – 1,340,800 €;
- Punimet në Sallën Multifunktionale në Prizren, të cilat janë në fazën përfundimtare.

Projektet në zhvillim e sipër:

- Ndërtimi i Qendrës Kulturore në fshatin Pouskë (punimet drejt përfundimit);
- Ndërtimi dhe restaurimi i Kullës në Gjonaj;
- Ndërtimi i Stadiumit Kabash - Has;
- Ndërtimi i Qendrës Kulturore Turke në Prizren;
- Renovimi i Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit;
- Renovimi i Qendrës Sportive “Sezai Surroi” (izolimi i jashtëm dhe dritaret);
- Punimet në Qendrën Turke dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e projekteve kapitale.

Projektet e iniciuara dhe procedurat e nisura:

- Nisja e procedurave për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Piranë;
- Nisja e procedurave për ndërtimin e Sallës së Mundjes në Tusus;
- Nisja e procedurave për ndërtimin e Palestrës Sportive në Qendrën Sportive;
- Barkodimi i aseteve në kuadër të procesit të inventarizimit të DKRS-së.

Mbështetja financiare dhe bashkëpunimi me OJQ-të

Gjatë vitit 2025, DKRS-ja ka vazhduar me monitorimin e rregullt të OJQ-ve kulturore, rinore dhe sportive, në përputhje me planifikimin dhe marrëveshjet e nënshkruara.

Është përfunduar procesi i mbështetjes financiare për OJQ-të dhe individët nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit për vitin 2025, me vlerë totale mbi 1.3 milion euro, duke përkrahur projekte që kontribuojnë në:

- zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike;
- fuqizimin e rinisë;
- promovimin e sportit dhe jetesës aktive;
- rritjen e përfshirjes komunitare.

Gjithashtu, janë përfunduar pagesat subvencionuese të mbetura nga viti 2024 gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 dhe ka vazhduar pagesa për marrëveshjen me Eko-Regjionin.

Organizimi i aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive

Gjatë vitit 2025, DKRS-ja ka organizuar dhe mbështetur një numër të madh aktiviteteve me rëndësi kulturore, rinore dhe sportive, duke e afirmuar Prizrenin si qendër të gjallë kulturore.

Aktivitetet dhe festivalet kryesore:

- Organizimi i festës së 17 Shkurtit – Pavarësia e Kosovës;
- Festivali për Fëmijë “Fluturat 2025” (1 Qershor);
- Festivali Folklorik për Fëmijë “URA 2025” (8–9 Qershor);
- Organizimi i festave të 10 Qershorit – Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe 12 Qershorit – Dita e Çlirimit të Prizrenit;
- Edicioni i 3-të i turneut ndërkombëtar FIBA 3x3 “Lite Quest 2025”, me pjesëmarrjen e 12 ekipeve;
- Festivali “Sofra Prizrenase”;
- Zambaku i Prizrenit 2025;
- Ngom Fest;
- Festivali Ndërkombëtar i Teatrit të Hapur “Prizren Fest” – Edicioni III;
- Oldtimer Fest Prizren 2025;
- Turneu memorial ndërkombëtar i boksit “Komandant Drini”;
- Festivali i stripit dhe karikaturës;
- Organizimi i aktiviteteve për 28 Nëntorin – Ditën e Flamurit Kombëtar.


Këto aktivitete kanë pasur pjesëmarrje të gjerë qytetare dhe kanë kontribuar në promovimin e kulturës, traditës dhe sportit në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Vlerësim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2025, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka dëshmuar angazhim të vazhdueshëm dhe kapacitete profesionale në realizimin e projekteve kapitale, mbështetjen financiare të sektorit kulturor, rinor dhe sportiv si dhe në organizimin e aktiviteteve me ndikim të drejtpërdrejt në jetën publike të qytetit.

Investimet në infrastrukturë, përkrahja e OJQ-ve dhe kalendari i pasur i ngjarjeve kulturore dhe sportive kanë kontribuar në rritjen e cilësisë së jetës, forcimin e identitetit kulturor dhe afirmimin e Prizrenit si qendër e rëndësishme kulturore në Kosovë dhe më gjerë.

Më poshtë gjeni në fotografi të punimeve dhe aktiviteteve në terren:







DREJTORIA E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik ka vazhduar me angazhime të shumta për zhvillimin dhe promovimin e potencialeve turistike të komunës sonë. Me investime strategjike në infrastrukturë, mbështetje për zanatet tradicionale dhe pjesëmarrje aktive në panaire lokale dhe ndërkombëtare, synojmë të fuqizojmë turizmin si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social në rajonin tonë.

Ky raport përmbledh arritjet, investimet dhe aktivitetet kryesore të kësaj periudhe.

Projektet e përfunduara dhe investimet kryesore:

- **Fshati Poslisht:** Përrurimi më 14 maj 2025 i destinacionit të ri turistik, me qëllim promovimin dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale.
- **Rrugët në Skorobisht:** Hapje dhe përrurim më 21 maj 2025 i rrugës 1.2 km për të përmirësuar infrastrukturën turistike dhe jetesën e banorëve.
- **Objekti administrativ për zejtarët Esnaf:** Fillimi i ndërtimit më 21 mars 2025 për përmirësimin e kushteve të biznesit dhe trajnimeve lokale.
- **Investime në Gurrin e Kallugjerit:** Vazhdon hapja e rrugëve malore për lidhjen e fshatrave Jeshkovë, Billushë dhe Opojë.
- **Fshati Vlashnje:** Nënshkrimi i kontratës për hapjen e rrugës malore drejt Murrademit; punimet pritet të fillojnë së shpejti.

- **Fshati Zhur:** Kontratë për vazhdimin e rrugës ekzistuese me qëllim lidhjen dhe promovimin e pamjeve të qytetit.
- **Fshati Vërmicë:** Investime në rregullimin e dy burimeve të ujit; përfundimi pritet në dy muaj, duke krijuar destinacion turistik të ri.



Aktivitetet kryesore:

- **Trajnime profesionale:** Janë trajnuar falas 48 persona në prill në disa fusha si modelim, qëndisje, punë me dru dhe dekorime.
- **Zhvillimi i zejeve tradicionale:** Trajnime në filigran, një zanat tradicional i Prizrenit, për rreth 30 të rinj dhe të reja.



Panairet:

- Organizim dhe mbështetje për panairet e turizmit, përfshirë pjesëmarrje aktive në panaire lokale dhe ndërkombëtare.
- Për herë të parë, Komuna e Prizrenit u promovua në panairin “Colors of the World” në Turqi, duke prezantuar potencialet turistike në nivel global.



Drejtorja për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik gjatë periudhës Qershor – Dhjetor 2025 ka filluar dhe përfunduar këto projekte dhe aktivitete:

➤ Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve Esnaf

Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Komunës së Prizrenit, më 21 Mars 2025 filloi ndërtimi i objektit me qëllim të sigurimit të kushteve të përshtatshme për bizneset vendore dhe ofrimi i kushteve dhe hapësirave të reja për mbajtjen e trajnimeve. Ky projekt ende është duke vazhduar dhe pritet përfundimi i tij gjatë vitit 2026.





➤ Investime në Gurrin e Kallugjerit

Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik gjatë vitit të kaluar ka filluar investimet në hapjen e rrugëve malore Jeshkovë – Billushë, me çrast do të bëhet lidhja e tri fshatrave (Opojë, Billushë, Jeshkovë). Punimet janë në përfundim e sipërm dhe pritet përfundimi i projektit së shpejti. Investimi në këtë zonë është në shumë prej 365, 322,00 euro.



➤ Investime në fshatin Vlashnje

Gjatë muajit Qershor është bërë lidhja e kontratës së re për hapjen dhe rrugullimin e infrastrukturës malore në fshatin Vlashnje gjerë në fshatin Murrademë. Punimet në këtë zonë janë duke u zhvilluar dhe gjatë vitit 2026 do të bëhet përfundimi i projektit. Vlera e kontraktuar për këtë projekt është 532,835.27 euro.



➤ **Investime në fshatin Zhur**

Gjithashtu gjatë muajit Qershor është bërë lidhja e kontratës së re, për vazhdimin e rrugës ekzistuese në fshatin Zhur, sipas kërkesave të banorëve dhe me qëllim të lidhjes së rrugës për ofrimin e pamjeve më të bukura të qytetit të Prizrenit. Në fshatin Zhur me datë 19.09.2025 u përurua hapja e rrugës malore, investim që ka përmirësuar infrastrukturën rrugore dhe ka lehtësuar qasjen drejt zonave me potencial të madh turistik si Bjeshkët e Zhurit, Vërmica dhe Opoja.

Projekti ka ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e turizmit malor, e cila ka rritur mundësitë për zhvillim ekonomik dhe të përmirësojë jetën e përditshme të banorëve të zonës.



➤ Investime në fshatin Vërmicë

Gjatë muajit Shtator kanë filluar punimet në realizimin e projektit për investimin në infrastrukturës në dy burimet e ujit në fshatin Vërmicë. Ky projekt është ndërprerë për shkak të mungesës së mjeteve. Pritet përfundimi i tij gjatë vitit 2026.



Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, një vëmendje të veçantë i ka dhënë mbështetjes së trajnimeve profesionale, ku deri më tani rreth 52 persona kanë marrë trajnim profesional pa pagesë. Gjatë muajit Gusht është bërë certifikimi i pjesëmarrësve në kurse, në kategori të ndryshme: atë të veshjeve - modelimit, të qëndisjes, të djgies në dru, të relievit, dhe punës me dekorime të ndryshme. Ndërsa me datë 26 Shtator 2025, ka filluar faza tjetër e kurseve, ku aktualisht marrin pjesë 60 gra dhe të reja.



Poashtu është bërë vazhdimi i edukimit profesional të zejeve tradicionale dhe ngritjes ekonomike siç është Filigrani, zeje kjo që ka karakterizuar qytetin tonë ndër shekuj e në të cilën kemi investuar dhe mundësuar trajnimin e kandidatëve të të gjitha gjinive e grupmoshave, dhe gjerë më tani, kemi mundësuar trajnimin profesional të 26 të rinjëve.

Panairët janë një kategori shumë e rëndësishme e lëmisë së turizmit, sidomos e pjesës së promovimit të tij dhe si të tilla janë trajtuar edhe nga Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik e cila ka qenë pjesë e organizimeve të shumta të projekteve të ndryshme që kryefjalë kanë pasur panairët. Ndërsa, si Drejtori kemi kontribuar në pjesëmarrje edhe në Panairët ndërkombëtarë të gjithë tour-operatorëve, hotelet, agjencioneve turistike dhe mediave lokale të interesuara të cilat ne si Komunë e Prizrenit, kemi mundësuar mbështetjen më anë të participimit, kemi mundësuar sigurimin e hapësirës për promovim për të parën herë në Komunë, në panairë si:

Me ftesë të Kryetarit të Komunës së Izmit, drejtori i Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik i Komunës së Prizrenit, së bashku me zyrtarë të komunës, morën pjesë në Panairin e 94-të Ndërkombëtar të Izmit, i cili u mbajt nga 29 gusht – 9 shtator 2025.

Ky panair është një ndër ngjarjet më të rëndësishme në rajon që mbledh qytete nga Ballkani dhe më gjerë, duke u bërë një platformë e fuqishme për promovimin e turizmit, kulturës, bashkëpunimit ekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Pjesëmarrja e Komunës së Prizrenit në këtë aktivitet është hap i rëndësishëm drejt forcimit të lidhjeve si dy qytete të binjakëzuara, krijojnë mundësi të reja të bashkëpunimit dhe promovimit të potencialit të pasur kulturor e turistik të qytetit .



Me datë 04 Tetor 2025 u mbajt Panairi Tradicional i Prizrenit - ngjarje që ka bashkuar prodhues vendorë, artizanë dhe biznese lokale, të cilat kanë prezantuar produktet e tyre, si dhe kanë promovuar trashëgiminë, turizmin dhe ekonominë lokale.

Panairi ka vazhduar gjatë pasdites me atmosferë festive, muzikë dhe aktivitete për vizitorët, duke e shndërruar qendrën e Prizrenit në një hapësirë plot gjallëri e kreativitet.





Më 04 Gusht 2025, është bërë nënshkrimi i kontratave me përfituesit e mbështetjes financiare për organizatat joqeveritare që ushtrojnë veprimtarit në dy fusha të thirrjes, atë të turizmit dhe të zhvillimit ekonomik. Ky proces mbështet iniciativat lokale në fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik, duke nxitur rritjen e bizneseve dhe promovimin e potencialit vendor. Fuqizimi i këtyre sektorëve është ndër prioritetet tona si Kryeqytet Historik i Kosovës.



DREJTORIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Raport pasqyron aktivitetet dhe angazhimet e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, duke përfshirë të gjitha çështjet që lidhen me mirëqenien sociale në Komunën e Prizrenit. Në të paraqiten në mënyrë të përmbledhur veprimtaritë e realizuara nga DPMS-ja në bashkëpunim të ngushtë me institucionet që janë nën përgjegjësinë e saj, si Qendra për Punë Sociale, Qendra Rezidenciale dhe Shtëpia për të Moshuar. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Drejtoria është përballur me disa sfida, përfshirë ndryshimet e shpeshta në kornizën ligjore, procesin e plotësimit të pozitive të lira në Drejtori dhe në Qendrën për Punë Sociale, si dhe menaxhimin e një numri të madh të lëndëve dhe kërkesave të trashëguara nga vitet e kaluara. Një sfidë tjetër madhore ka qenë buxheti i kufizuar, i cili ka ndikuar në mundësinë e realizimit të plotë të projekteve dhe aktiviteteve sociale. Ky raport synon të paraqesë një pasqyrë të qartë të punës së zhvilluar, sfidave të hasura dhe arritjeve të realizuara nga Drejtoria, në përpjekje për të përmirësuar mirëqenien sociale të komunitetit në Komunën e Prizrenit.

Në tabelë është paraqitur numri i personelit të cilët janë të angazhuar aktualisht, ku në kabinetin e drejtorisë janë të angazhuar vetëm 2 persona.

	DPMS	QPS	SHPAK	SHM
Nr. i punëtorëve	3	20	11	10

Projektet:

Projekti Ndërtimi i banesave sociale ne Lagjen Petrovë Kulla 4 (vazhdim i projektit)

Po vazhdojnë punimet për përfundimin e këtij objekti, punët e të cilit janë ndërprerë vite me parë. Projekti është duke u zhvilluar sipas planit dinamik.

Renovimi i banesave kolektive në Lagjen Petrovë Kulla 3 (vazhdim i projektit)

Ka përfunduar jemi ne fazën e kyçjes në sistemin elektrik.

Furnizim me inventar për shtëpinë e të moshuarve

Ka përfunduar si projekt. Së shpejti fillon me pranimin e rezidentëve të parë.

Ndërtimi i Qendrës për Punë Sociale 2 (QPS 2) – Ka përfunduar.

Ndërtimi kulmeve për familjet skamnore - Jemi në procedurë të rregullimit, kanë përfunduar 26 kulme.

Ndërtimi i shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve. Janë duke vazhduar punimet.

Ndërtimi i qendrës rekreative sportive - po vazhdojnë punimet.

Furnizimi dhe vendosja e ashensorëve në QPS2 dhe shtëpinë për të moshuar – jemi në fazën e tenderimit.

Projektet tjera:

- **Furnizimi me ushqim dhe pije për shtëpinë me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuara** – rrjedh si kërkesë e plotësimit të nevojave nga rezidentët e shtëpisë me bazë në komunitet për persona me probleme të shëndetit mendor,
- **Furnizim me veshmbathje për shtëpinë me bazë në komunitet për persona me probleme të shëndetit mendor dhe shtëpisë së të moshuarve** - vazhdon si projekt,
- **Hartim i projekteve të ndryshme për DPMS,**
- **Shërbime transporti për bartjen e fëmijëve dhe familjarëve të tyre me vështirësi sociale,**
- **Mbikëqyrje e punimeve të projekteve të DPMS-së** – është kontratë e cila rrjedh si kërkesë e plotësimit të nevojave për mbikëqyrjen e projekteve të DPMS-së. Projekt dy vjeçar i cili vijon.
- **Furnizim me produkte hixhenike për shtëpinë rezidenciale** – është kontratë e cila rrjedh si kërkesë e plotësimit të nevojave për banorët e shtëpisë rezidenciale.

Subvencionet:

- **Mbulimi i shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit** – ku është arritur marrëveshja me Ndërmarrjen Publike “Eko-Regjioni” dhe bashkësitë fetare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit dhe mirëmbajtjen e hapësirave. Edhe më tutje vazhdojnë pagesat sipas faturave mujore bazuar në rastet e vdekjeve në Komunën e Prizrenit.

- **Subvencionimi i realizimit të projekteve të OJQ-ve dhe individëve në fushën e shërbimeve sociale:** DPMS-ja ka mbështetur 21 OJQ në vlerën totale prej 100,000.00 eurove,
- **Subvencionimi i familjeve strehuese** - Këtu kemi paraparë pagesën e familjeve strehuese që strehojnë fëmijë të braktisur të komunës sonë. Vlera e paraparë për këtë kategori është 25.000.00 euro,
- **Subvencionimi i familjeve në vështirësi ekonomike me pagesë të qirasë** – 16 familje,
- **Me vendim të Kryetarit paguajmë qira për 11 familje të marginalizuara,**
- **Projekti mbështetje për nënat që kanë lindur fëmijë gjatë vitit 2024:** Kanë aplikuar 1478 dhe ka përfunduar.

Memorandume bashkëpunimi:

- **Memorandum bashkëfinancimi me OJQ “Jetimat e Ballkanit”.** Ky projekt ka për qëllim ndërtimin e 50 shtëpive për rastet sociale dhe grupet e marginalizuara. Jemi në fazën e marrjes së lejes për ndërtimin e këtyre shtëpive.
- **Terres des Hommes** – Po vazhdon projekti ndërmjet Komunës së Prizren dhe OJQ “TDHK” në qendrën ditore Nashec, projekt i cili ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve duke iu ofruar qëndrim ditor kualitativ dhe ambient sipas standardeve më të larta vlera e mbështetjes 45,000.00 euro.
- **Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe OJQ CONCORDIA** - Ky projekt ka për qëllim bashkëpunimi dhe koordinimi të aktiviteteve për t'u mundësuar fëmijëve, të rinjve, grave, familjeve dhe komuniteteve të cenuara në Komunën e Prizrenit që të bëjnë një jetë të vetëvendosur pa marginalizimin dhe diskriminimin, duke fuqizuar sistemin lokal të mirëqenies. Ky projekt është subvencionuar me 29.000,00 euro.
- **Shtëpia me bazë në komunitet (Rezidenciale)** - Shtëpia me bazë në komunitet për personat me probleme mendore, janë të vendosur 14 persona.

Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale është institucion i cili vepron në kuadër të Komunës së Prizrenit. QPS-ja ka për detyrë të ofroj shërbime profesionale të mbrojtjes sociale dhe të ushtroj autoritetin e saj i cili buron nga ligjet mbi mbrojtjen sociale dhe nga ligjet tjera relevante si dhe ato ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të dedikuara për mbrojtjen e viktimave të dhunës, trafikimit, çrregullimeve familjare, besimi i fëmijëve, kujdestaria (kujdesi ndaj fëmijëve), të rriturve dhe të moshuarve. Në kuadër të Qendrës për Punë Sociale funksionojnë dy shërbime: Shërbimit social familjardhe shema e asistencës sociale.

Shërbimet Sociale Familjare - Raporti i shërbimeve sociale familjare për periudhën Janar – dhjetor 2025 është si në vijim:

Kategoritë	Totali	Sqarim i shkurtër
Fëmijët e braktisur		Strehim, kujdes shëndetësor, siguri, edukim, etj.
Adoptim/ Kërkesë	3	
Fëmijët në periodë adoptuese	2	
Fëmijët në streh.familja.të trajnuara	4	
Fëmijët në strehim - kujdestari te të afërmit PA PAGESË	2	
Fëmijët në strehim - kujdestari te të afërmit ME PAGESË	4	Strehim, kujdes, edukim, mbështetje, mbrojtje sociale
Fëmijët me nevoja të veçanta	61	Përgatitja e dosjes, aplikim, udhëzime dhe përcjellja e rastit, vizita familjare.
Regjistrimi i mëvonshëm i fëmijëve	1	Deklaratat, vlerësimi i nevojave sociale dhe raporti
Fëmijët e abuzuar, të keqtrajtuar	2	
Të mitur, Prokuroria Themelore	117	Vlerësimi, mbrojtja, asistimi dhe rekomandimet sociale
Të mitur, Gjykata.Them.Kundërva.	33	Vlerësimi, mendimi, rekomandimet sociale
Kërkesat,vlerësimet për adoptim	4	
Kërkesat për vlerësimin e familjeve strehuese	1	Vlerësimi i rrethanave sociale dhe mendimi profesional
Martesa e të miturve	4	Këshilla, sugjerime dhe mbështetje sociale
Viktimat e dhunës ne familje - të rritura trajtim	114	Mbrojtja, siguria, kujdesi shëndetësor, strehimi
Viktimat e dhunës në familje – fëmijë 0-18 vjeç - trajtim	34	Mbështetje sociale
Viktimat e strehuara në strehimore me fëmijë	16	E strehuar, pa femije.
Urdhërmbrojtje	29	Mbështetje sociale
Tentim vetëvrasje	3	Trajtimi, mbështetje sociale, referim ne Sh.M

Trashëgimi - pëlqim	18	Pëlqim duke mbrojtun interesat e fëmijëve
Shkurorëzimet	68	Vlerësimi, mendimi profesional, këshilla e mbështetja sociale
Besimi i fëmijëve	47	Vlerësimi, mendimi profesional, këshilla e mbështetja sociale
Kontakt i fëmijëve me prindin tjetër	153	Organizimi, vlerësimi e përcjellja e kontaktimeve
Bashkimi familjar - të moshuar	10	Vlerësimi social për bashkim familjar
Mosmarrëveshjet familjare	35	Këshilla, sugjerime për sanim të raporteve familjare
Heqja e zotësisë së veprimit	5	Caktimi i kujdestarit për klientët në procedurë
Të strehuar të moshuar	2	
Të strehuarit në shtëpi rezidenciale-strehimore - Gjakovë	2	Vlerësimi, mendimi profesional për panel, strehim
Kujdestari për rastet e veçanta	12	Caktimi i kujdestarit për procedurat e nevojshme
Vërtetim për armë	598	Dëshmi për personin a është në kujdestari
Vërtetim për nënshtetësi	74	Dëshmi për personin a është në kujdestari
Vërtetim për punë	94	Dëshmi për personin a është në kujdestari
Fëmijët në situatë rruge	15	
Anamnezë – vërtetë gjendje sociale	14	Vlerësimi i rrethanave sociale dhe mendimi profesional
Pëlqim për pasaportë	48	
Asistim në polici	121	Vlerësimi, mbrojtja, asistimi dhe rekomandimet sociale
Përfaqësim në gjykatë	198	Vlerësimi, mendim, mbrojtja dhe rekomandimet sociale
Përfaqësim në prokurori	39	Vlerësimi, mbrojtja dhe rekomandimet sociale
Vizitë në QSGF	63	Deklaratë, vlerësim, bashkëpunim dhe rehabilitim
Vizita në terren	162	Procedim për KM të FNV

Përgatitja e lëndëve për KM të FNV	162	Dërgimi i fëmijëve tek i ati
Vizitë në burgun e Dubravës/ Strehimore Lipjan	13	
Dërgimi i të miturës në spital	4	
Caktimi i Kujdestarit	6	
Komisioni DKA	6	Vlerësim, rekomandim, procedim, mbështetje sociale
Heqje e të drejtës prindërore	1	
TMR	1	Takim me akterët inst. dhe familjar
Te tjera	13	

Skema e asistencës sociale pranë QPS-së në Prizren gjatë periudhës kohore Janar-Nëntor 2025, ka punuar në identifikimin e rasteve sociale, vlerësimin dhe monitorimin e tyre, gjithnjë duke u bazuar në ligjin e asistencës sociale 2003/15 dhe plotësim ndryshimin e Ligjit 04L-096 për Skemën e ndihmës sociale i zbatueshëm në Republikën e Kosovës, gjithashtu gjatë kësaj periudhe ka filluar edhe procedura e pilot projektit të skemës sociale ku deri më tani kemi verifikuar dhe vlerësuar mbi 2517 raste të reja gjatë muajve Janar-Nëntor 2025. Numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në kohën raportuese është 581 familje me 1995 anëtarë.

Muaji	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve	Shuma e mjeteve në total €
Janar	609	2061	70.550,00
Shkurt	602	2041	69.190,00
Mars	606	2062	69.870,00
Prill	593	2000	67.920,00
Maj	596	2031	68.580,00
Qershor	597	2031	68.770,00
Korrik	592	2025	68.230,00
Gusht	593	2031	68.410,00
Shtator	586	2002	67.370,00

Tetor	587	2008	81.048.00
Nëntor	581	1995	80.484.00
Gjithsejt	Varion nga 609 në muajin Janar 2025, deri në 581 familje në muajin Nëntor 2025	Varion nga 2061 deri 1995 anëtarë	780.422.00

Numri i familjeve të verifikuara – riverifikuara gjatë periudhës Janar - maj 2025


AKTIVITETET	KATEGORIA I	KATEGORIA II	TOTALI
Numri i familjeve të verifikuara –	503	150	653

DREJTORIA E GJEODEZIZË DHE KADASTRIT

Gjatë këtij viti janë pranuar **21552** kërkesa në kuadër të sektorit të gjeodezisë dhe kadastrit: si kontratat e shitblerjes, kontratat e dhurimit, aktgjykimet, aktvendimet, lista poseduese, kopje të planit, ndarjet e parcelave, bashkimet e parcelave, regjistrimet e objekteve dhe pjesëve të objekteve. Nga këto lloje të lëndëve:

- 21553 kërkesa janë miratuar,
- 998 janë ne proces e sipër,
- 334 kërkesa janë refuzuar,
- 78 janë pezulluar,
- 54 janë te anuluar për shkaqe të gabimeve teknike.¹

¹ Këto të dhëna janë marrë nga sistemi zyrtar Intranet dhe paraqesin pasqyrën e lëndëve deri më datën 26.11.2025



Në këtë periudhë nga shërbimet të lartë përmendura janë grumbulluar të hyra prej 277,278 euro², apo **59%** e të hyrave kësaj drejtorie.

Aktivitetet më të rëndësishme që janë marrë në këtë periudhë janë:

- **Legalizimi:** Janë regjistruar 304 vendime të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor sipas ligjit për ndërtimet pa leje dhe të gjitha këto objekte tani janë të evidentuara në regjistrat kadastrale, ku për secilën ekzistojnë certifikata të pronës.
- **Rindërtimi i kadastrit:** Në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës është nisur projekti i rindërtimit të Zonave Kadastrale Zhur, Landovicë, Pllanjane, Lez dhe Lubinjë të Epërme për zgjidhjen e problemeve pronësore – juridike.
- **Piketimet:** Gjatë kohës raportuese sipas kërkesave të Drejtorive janë kryer piketimet e rrugëve, objekteve komunale dhe hapësirave publike.

² Këto të dhëna janë të datës 26.11.2025 të dërguara nga Drejtoria e Financave.

- **Matjet Gjeodezike:** Janë bërë matjet në teren sipas kërkesave të drejtorive për incizimet e gjendjeve faktike dhe projektet të cilat janë kërkuar nga drejtoritë përkatëse.

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjatë periudhës raportuese, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në realizimin e objektivave të përcaktuara me Planin e Punës 2025, Planet dhe Programet tjera zhvillimore, ligjeve, vendimeve, akteve tjera normative si dhe kërkesave të ndryshme të fermerëve dhe grupeve tjera.

Gjatë kësaj periudhe DBZHR-ja ka arritur t'i realizojë objektivat e përcaktuara me Planin e Punës 2025, me synimin kryesor avancimin e pozitës së fermerëve, përmirësim të kualitetit të prodhimeve dhe përpunimeve, zhvillimin e bujqësisë intensive dhe të qëndrueshme të orientuar nga tregu dhe konkurrenca e lirë.

Objektivat e arritura:

- Shfrytëzimi efikas dhe i qëndrueshëm i tokës bujqësore dhe resurseve tjera natyrore;
- Rritja e prodhimit në fermë duke përmirësuar zinxhirin e vlerës;
- Rritja e mbështetjes financiare për fermat;
- Krijimi i mundësive të punësimit në zonat rurale, veçanërisht përmes diversifikimit rural.

Aktivitetet kryesore:

- Shfrytëzimi racional i tokës bujqësore dhe mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të pa planifikuar dhe aktivitetet tjera që kanë qëllime jo bujqësore;
- Hartimi dhe zbatimi i Programit për Investime kapitale/subvencione dhe shërbime;
- Organizimi i shërbimeve këshillimore dhe trajnimeve në aplikimin e mbrojtjes së integruar sipas veprimtarive prodhuese bujqësore;
- Furnizimi me pajisje të ndryshme bujqësore varësisht prej veprimtarisë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar gjithsej 192 kërkesa me shkrim nga lëmi të ndryshme, prej tyre 168 janë miratuar, 15 janë në proces, 3 janë hedhur poshtë, 4 janë refuzuar dhe 2 janë pezulluar.

Ky raport në përmbajtje paraqet të dhënat për projektet kapitale, projektet me bashkëfinancim, mallra dhe shërbime, kategoritë mbështetëse subvencionuese për secilën kategori.

Projektet në realizim

Kapitale:

Nr	Emërtimi i projektit	Shuma e planifikuar janar-dhjetor 2025 €	Shuma e realizuar janar-dhjetor 2025 €
1.	Rehabilitimi i kanaleve ujitëse dhe pastrimi i kanaleve kulluese	160,000.00	76,839.00
2.	Ndërtimi i strehimores për qenë endacakë	274,078.50	181,600.00
3.	Rehabilitimi i rrugëve fushore	193,333.33	133,333.00
	Totali	627,411.83	391,772.00

Punët për projektet e lartpërmendura janë kryer në tërësi por kanë munguar mjetet financiare për pagesën e tyre. Kjo vlenë edhe për projektet tjera. Pra Drejtoria e Bujqësisë të gjitha projektet e planifikuara i ka përfunduar.

Subvencione me bashkëfinancim:

Nr	Emërtimi i projektit	Shuma e planifikuar janar - dhjetor 2025 €	Shuma e realizuar janar - dhjetor 2025 €
1.	Ngritja e pemishteve me pemë të imta – dredhëza dhe Boronicë (kontratë kornizë 2 vjeçare)	149,956.00	220,970.00
2.	Ngritja e pemishtes me pemë arvore (kontratë kornizë dy vjeçare)	49,635.00	20,000.00
3.	Ndërtimi i stallave për bagëti të imta dele, dhi -Vazhdim i projektit	109,681.95	109,681.95
4.	Ndërtimi i stallave për lopë qumështore – Vazhdim i projektit	55,342.02	0
5.	Mekanizma bujqësore	378,870.00	279,180.00
6.	Hapja e puseve për ujitjen e tokave bujqësore (kontratë kornizë dy vjeçare)	89,730.00	0
	Totali	833,214.97	629,831.95

Shërbime:

Nr	Emërtimi i projektit	Shuma planifikuar janar - dhjetor 2025 €	Shuma e realizuar janar - dhjetor 2025
1.	Trajtimi i qenve endacakë (kontratë kornizë 3 vjeçare)	72,400.00	40,934.00
2.	Inseminimi artificial i lopëve dhe vaksinimi i deleve (kontratë kornizë 3 vjeçare)	103,300.00	135,952.00
3.	Vaksinimi kundër brucelozës (kontratë kornizë 3 vjeçare)	68,400.00	162,992.40
	Totali	244,100.00	339,878.40

Vërejtje:

Vlerat e larta të realizimit në projektet “ Inseminimi artificial i lopëve dhe vaksinimi i deleve “ si dhe ati” Vaksinimi i deleve kundër brucelozës” kanë ardhur si rezultat i pagesave të borgjeve nga viti paraprak si dhe punët shtesë që janë realizuar me rritjen e numrit të deleve nga viti në vit .(Kemi të bëjmë me kontrata kornizë 3 vjeçare.)

Projektet në realizim janar - dhjetor 2025..... 1,704,726.80 €

Pagesat e realizuara janar - dhjetor 2025..... 1,360,482.35 €

Buxheti i realizuar gjatë kësaj periudhe ka qenë79.80%

Aktivitetet tjera:

- Janë realizuar 1.457 aplikime për fermer për Pegesa Direkte për MBPZHR – AZHB-në si dhe 940 aplikues për subvencione në bujqësi.
- Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore dhe krijimi i rrjetit të të dhënave.
- Janë organizuar 19 trajnime me fermer përmes projektit “Zhvillimi i zonave rurale për avancimin e shërbimeve këshilluse.
- Mbajtja e praktikës profesionale me studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” dega Agrobiznes.

- Pjesmarrje në Panaire Bujqësore të organizuara nga Institucionet dhe Shoqatat e ndryshme.

Drejtorja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural varësisht prej nevojës është angazhuar në mënyrë aktive edhe në shumë aktivitete tjera të iniciuara nga autoritete të ndryshme publike në nivel lokal, regional dhe qendror.

Më poshtë gjeni në fotografi të punimeve dhe aktiviteteve në terren:



PËRMBLEDHJE PËRFUNDIMTARE

Një vit pune, themele të qëndrueshme për të ardhmen.

Viti 2025 për Komunën e Prizrenit ka qenë vit i punës intensive, i konsolidimit institucional dhe i vazhdimit të projekteve me rëndësi strategjike për zhvillimin e qytetit dhe përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve. Ky raport pasqyron në mënyrë të detajuar angazhimin e institucioneve komunale, drejtorive dhe njësive përkatëse si dhe rezultatet konkrete të arritura gjatë këtij viti, në fusha kyçe si administrata publike, shëndetësia, arsimi, infrastruktura, planifikimi urban, kultura, sporti, siguria, financat dhe shërbimet për qytetarët.

Në një kontekst të përgjithshëm të sfidave ekonomike, sociale dhe institucionale, Komuna e Prizrenit ka arritur të ruajë stabilitetin funksional, të avancojë projekte të rëndësishme kapitale dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimeve publike. Ky vit nuk ka qenë vetëm vazhdimësi e punëve të nisura më herët, por edhe një periudhë në të cilën janë vendosur themele të qëndrueshme për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë të Komunës.

Qeverisje funksionale dhe administratë në shërbim të qytetarëve

Gjatë vitit 2025, administrata komunale ka funksionuar mbi parimin e përgjegjshmërisë institucionale, transparencës dhe shërbimit ndaj qytetarit. Drejtoritë komunale dhe njësitë vartëse kanë trajtuar një numër të madh kërkesash administrative, kanë menaxhuar procese komplekse ligjore dhe financiare dhe kanë ofruar shërbime të përditshme për mijëra qytetarë.

Përmirësimi i proceseve administrative, digjitalizimi gradual i shërbimeve dhe koordinimi ndërmjet drejtorive kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit dhe në shkurtimin e kohës së trajtimit të kërkesave. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimit të kapaciteteve profesionale dhe respektimit të procedurave ligjore në rekrutime dhe administrimin e personelit.

Stabilitet financiar dhe menaxhim i përgjegjshëm i buxhetit

Viti 2025 është karakterizuar nga një menaxhim i kujdesshëm dhe i disiplinuar i buxhetit komunal. Të hyrat vetanake janë realizuar në nivel të kënaqshëm, ndërsa shpenzimet buxhetore janë menaxhuar në mënyrë të kontrolluar, duke ruajtur balancën ndërmjet nevojave operative dhe investimeve kapitale.

Transparenca financiare, raportimi i rregullt dhe zbatimi korrekt i procedurave kanë qenë elemente kyçe të punës së Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa. Kjo ka krijuar bazë të qëndrueshme për vazhdimin e projekteve zhvillimore dhe për sigurimin e stabilitetit fiskal të Komunës edhe në vitet në vijim.

Investime publike dhe zhvillim urban i planifikuar

Gjatë vitit 2025, Komuna e Prizrenit ka vazhduar investimet në infrastrukturë, objekte publike dhe planifikim urban. Projektet kapitale në shëndetësi, arsim, kulturë, sport dhe shërbime publike kanë qenë pjesë e një qasjeje të planifikuar, me synim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe rritjen e funksionalitetit urban.

Proceset e planifikimit hapësinor, përfshirë hartimin dhe avancimin e dokumenteve strategjike, kanë krijuar një bazë të rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm, duke balancuar nevojat e rritjes urbane me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit. Legalizimet dhe rregullimi urban kanë qenë ndër proceset më të ndjeshme, por edhe më të domosdoshme për sigurimin e rendit dhe sigurisë juridike për qytetarët.

Shëndetësia, siguria dhe shërbimet sociale

Shëndetësia komunale gjatë vitit 2025 ka përballuar një volum shumë të madh shërbimesh për qytetarët, duke dëshmuar rëndësinë e investimeve në infrastrukturë, pajisje mjekësore dhe burime njerëzore. Modernizimi i objekteve shëndetësore, furnizimi me pajisje dhe rritja e kapaciteteve kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Në të njëjtën kohë, Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri si dhe Drejtoria e Inspektorateve, kanë luajtur rol kyç në garantimin e sigurisë publike, reagimin ndaj emergjencave dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Këto shërbime, shpesh të padukshme në përditshmëri, përbëjnë shtyllë themelore të funksionimit të qytetit dhe mbrojtjes së jetës dhe pronës së qytetarëve.

Kulturë, rini dhe sport – identitet dhe gjallëri qytetare

Viti 2025 ka qenë vit i pasur me aktivitete kulturore, artistike dhe sportive, duke e afirmuar Prizrenin si qendër të rëndësishme kulturore në vend. Investimet në infrastrukturë kulturore dhe sportive, mbështetja për organizatat dhe individët si dhe organizimi i festivaleve dhe ngjarjeve publike kanë kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe në promovimin e vlerave kulturore dhe sportive.

Këto aktivitete nuk kanë pasur vetëm karakter festiv, por kanë shërbyer edhe si platformë për bashkëpunim, integrim dhe zhvillim të rinisë, duke ndikuar pozitivisht në jetën sociale të qytetit.

Partneritet, transparencë dhe besim qytetar

Gjatë vitit 2025, Komuna e Prizrenit ka vazhduar bashkëpunimin me institucione qendrore, organizata ndërkombëtare, donatorë dhe partnerë vendorë, duke siguruar mbështetje për projekte zhvillimore dhe sociale. Këto partneritete kanë qenë të rëndësishme për avancimin e kapaciteteve institucionale dhe realizimin e projekteve që tejkalojnë mundësitë buxhetore komunale.

Transparenca në punë, komunikimi publik dhe raportimi i rregullt kanë qenë elemente kyçe për ndërtimin dhe ruajtjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve komunale.

Shikimi përpara – përgjegjësi dhe vision

Viti 2025 nuk përbën një pikë përfundimtare, por një bazë të rëndësishme për punën që vazhdon. Sfidat mbeten të pranishme dhe kërkojnë angazhim të vazhdueshëm, planifikim të kujdesshëm dhe bashkëpunim të gjerë institucional dhe qytetar.

Komuna e Prizrenit do të vazhdojë të punojë me përkushtim për zhvillim të qëndrueshëm, përmirësim të shërbimeve publike dhe rritje të cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët, duke ruajtur vlerat e trashëgimisë kulturore dhe identitetin e qytetit.

Falënderim

Në përfundim, falënderoj të gjithë zyrtarët komunalë, drejtoritë, njësitë vartëse dhe partnerët institucionalë për angazhimin dhe kontributin e tyre gjatë vitit 2025. Një falënderim i veçantë u drejtohet qytetarëve të Prizrenit për bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe besimin e vazhdueshëm në institucionet komunale.

Ky raport pasqyron punën e përbashkët dhe përgjegjësinë tonë ndaj qytetit dhe të ardhmes së tij.

Me respekt,
Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit